**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE**
***Drejtoria e Administrimit te Prones Publike***

# URDHER

Nr. 137 Date 5.5.2004

**PER**

**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A. " PRODHIM MOBILJE" TIRANE**

Drejtuar : Sh.A. "Prodhim Mobilje" **Tirane**

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe neni 128, 150 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, me cilesine e aksionerit te vetem .

**URDHEROJ:**

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 32 694 000 leke, e barabarte me 32 694 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion, qe i perkasin vleres se objekteve "Reparti i Stazhionimit" dhe "Reparti Mekanik".
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Prodhim Mobilje" Tirane, **behet 47 306 000 leke** i barabarte me 47 306 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
   Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE TIRANE

Anastas ANGJELI

MINISTER

**RAPORT**
**I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE SH.A. "Prodhim Mobilje" TIRANE.**

Mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe ne urdherin Nr.91 date 08.04.2004 te Ministrit te Ekonomise me cilesine e aksionerit te vetem, per zvogelimin e kapitalit te Sh.A "Prodhim Mobilje" Tirane per objektet : "Reparti i Stazhionimit" dhe "Reparti Mekanik" fillova procedurat per pergatitjen e raportit si me poshte:

Per percaktimin e shumes qe do zvogelohet kapitali i shoqerise per dy repartet e mesiperme u mbeshteta ne Bilancin e mbylljes te dates 31.12.2003, ne inventarin fizik te kryer ne fund te vitit 2003, ne Gentplanin e vendosjes se objekteve, ne te dhenat e kontabilitetit persa i perket vleftes fillestare dhe vleftes se amortizuar te ketyre objekteve si dhe ne statutin e shoqerise.

Asetet e objekteve te mesiperme paraqiten si me poshte:

**Reparti i Stazhionimit**

| Emertimi | Njesi e matjes | Vlefta fillestare | Amoritizimi | Vlefta e mbetur |
|---|---|---|---|---|
| Ndertesa | lek | 10,231,600 | 4,852,800 | 5,378,800 |
| Makineri | lek | 1,015,451 | 826,081 | 189,370 |
| Toka | lek | 5,875,200 | 0 | 5,875,200 |
| Totali | lek | 17,122,251 | 5,678,881 | 11,443,370 |

**Reparti Mekanik**

| Emertimi | Njesi e matjes | Vlefta fillestare | Amoritizimi | Vlefta e mbetur |
|---|---|---|---|---|
| Ndertesa | lek | 29,519,641 | 13,072,900 | 16,446,741 |
| Makineri | lek | 380,431 | 333,342 | 47,089 |
| Toka | lek | 4,756,800 | 0 | 4,756,800 |
| Totali | lek | 34656872 | 13,406,242 | 21,250,630 |

Ne vleren e tokes sipas gent-planit nuk jane perfshire rruget e lira.
Vleresimi i tokes eshte marre sipas kontabilitetit me 800 leke per m2.
Ne baze te te dhenave te paraqitura me siper kapitali i SH.A. "Prodhim Mobilje" zvogelohet per 32,694,000 leke.
Kapitali i Sh.A. "Prodhim Mobilje" behet 47,306,000 leke.
Duke qene se vlefta e nje aksioni mbetet 1000 leke numeri i aksioneve ulet per 32,694 aksione.

Shoqeria te beje regjistrimin e zvogelimit te kapitalit ne Gjykate per 32,694,000 leke duke lene si kapital themeltar 47,306,000 leke te ndare ne 47,306 aksione.
***Bashkangjitur Bilanci***

**Eksperti Kontabel i Autorizuar**

**Prof. Jorgji BOLLANO**

Tirane 27.04.2004

*SH.A. PRODHIM MOBILJE*

***BILANCI***

| AKTIVI | Ishte 31.12.03 | Behet |
|---|---|---|
| | | |
| **Aktive te Qendrueshme te Trupezuara** | **66,997,538** | **34,303,538** |
| a. Toka, Troje, Terrene, Ndertime e inst.te pergjithshme | 117,942,117 | 67,558,876 |
| b. Instalime teknike, Makineri, Pajisje | 5,193,124 | 3,797,242 |
| c. Te tjera ne shfrytezim | 299,000 | 299,000 |
| d. Amortizimi | (56,436,703) | (37,351,580) |
| | | |
| **Aktive Qarkulluese** | **12,291,518** | **12,291,518** |
| Gjendje te inventarit dhe ne proces | 205,916 | 205,916 |
| a. Materiale te para dhe materiale te tjera | 33,419 | 33,419 |
| b. Prodhime e punime ne proces | 117,203 | 117,203 |
| c. Produkte e mallra | 41,964 | 41,964 |
| d. Te tjera gjendje inventari | 13,330 | 13,330 |
| | | |
| Kerkesa per arketim mbi debitore | 9,929,701 | 9,929,701 |
| a. Kliente | 8,817,591 | 8,817,591 |
| b. Te tjera kerkesa | 1,112,110 | 1,112,110 |
| | | |
| Likujditete dhe vlera arke te tjera | 2,155,901 | 2,155,901 |
| a. Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera | 2,064,134 | 2,064,134 |
| b. Para ne dore (Arke) | 91,767 | 91,767 |
| | | |
| **Totali I aktivit** | **79,289,056** | **46,595,056** |
| | | |

SH.A. PRODHIM MOBILJE TIRANE

Drejtori
Guri Sefezi

Shefe e llogarise
Zyhra Nimani

Eksperti kontabel, Autori
Jozef Bollano

*SH.A. PRODHIM MOBILJE*

***BILANCI***

| | PASIVI | Ishte 31.12.03 | Behet |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | **Kapitalet e veta** | **72,242,672** | **39,548,672** |
| | Kapitali themeltar, rezervat, fitime/humbje | 72,217,196 | 39,523,196 |
| | a. Kapitali I nenshkruar | 80,000,000 | 47,306,000 |
| | b. Diferenca nga rivleresimi | 1,069,793 | 1,069,793 |
| | c. Humbje te mbartura | (6,339,630) | (6,339,630) |
| | d. Humbje te ushtrimit | (2,512,967) | (2,512,967) |
| | Fonde te tjera | 25,476 | 25,476 |
| | | | |
| | **Detyrime** | **7,046,384** | **7,046,384** |
| | Detyrime te kerkueshme pa me shume se nje vit | 3,436,159 | 3,436,159 |
| | a. Te tjera detyrime | 3,436,159 | 3,436,159 |
| | | | |
| | Detyrime te kerkueshme deri ne nje vit | 3,610,225 | 3,610,225 |
| | a. Furnitore per blerje e sherbime | 135,825 | 135,825 |
| | b. Sigurime shoqerore | 150,459 | 150,459 |
| | c. Shteti tatime dhe taksa | 272,001 | 272,001 |
| | d. Te tjera detyrime | 3,051,940 | 3,051,940 |
| | | | |
| | **Totali I pasivit** | **79,289,056** | **46,595,056** |
| | | | |

Drejtori
Guri Seferi

Eksperti kontab i Autorizuar
Jorgji Bollano

Shefe e llogarise
Zyhra Nimani

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE**
***Drejtoria e Administrimit te Prones Publike***

**URDHER**
Nr. 91 Date 8.4.2004

**PER**
**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE**

Drejtuar: Sh.A "PRODHIM MOBILJE " TIRANE

Bazuar ne shkresen Nr.1651/1 date 12.03.2004 dhe shkreses nr.1839/1 date 31.03.2004, " Mbi privatizimin e disa objekteve te sh.a "Prodhim Mobilje",

**KONSTATOVA**

Se praktika eshte e plote dhe ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002 si dhe Ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me cilesine e aksionerit te vetem ,

**URDHEROJ:**

1. Zvogelimin e kapitalit te Sh.A "Prodhim Mobilje" Tirane per objektet: "Reparti i Stazhionimit" dhe "Reparti Mekanik".
2. Eksperti Kontabel i Autorizuar Z. Jorgji Bollano te pergatise raportin perkates ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij urdheri Drejtoria e Sh. A. " Prodhim Mobilje " Tirane.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

ARBEN ANGJELI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**NR. 20304/3 VENDIMI**

**VENDIM**
**I**
**GJYQTARIT TE VETEM**

Sot, me date 26.5.09, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ________, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zevendesministri i Ekonomise per depozitimin ne rregjistrin tregtar te Urdherit nr.137, date 05.05.2004 dhe,

**K O N S T A T O V A :**

Se shoqeria "Prodhim mobilje" sh.a Tirane eshte rregjistruar si shoqeri anonime me vendimin nr20304, date 10.11.1998.
Me urdherin nr.137, date 05.05.2004 te Ministrit te Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise eshte vendosur zvogelimi i kapitalit te shoqerise per vleren prej 32.694.000 leke e barabarte me 32.694 aksione dhe kapitali i shoqerise behet 47.306.000 leke, i barabarte me 47.306 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
Nga shqyrtimi i akteve te paraqitura nga kerkuesi rezulton se ato jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

**PER KETE ARSYE:**

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr.7667, date 28.01.1993

**V E N D O S A :**

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin e urdherit nr.137, date 05.05.2004 te Ministrit te Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise per zvogelimin e kapitalit te shoqerise "Prodhim mobilje" sh.a.Tirane per vleren prej 32.694.000 leke e barabarte me 32.694 aksione dhe kapitali i shoqerise behet 47.306.000 leke, i barabarte me 47.306 aksione me vlere nominale 1000 leke secili, duke bere shenimin ne fleten e rregjistrit ne kolonen 4 dhe 5 me numer rendor 2.
Te ndahen rregjistrimet nga njeri-tjetri.

**G J Y Q T A R E**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË**
***Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme***

**URDHER**
Nr. 116, Date 4.05.2005

**PER**
**ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE**
**"PRODHIM MOBILJE" SH.A. TIRANE**

*Drejtuar:* *Shoqerise "Prodhim Mobilje" Sh.a. Tirane*

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te nenit 2 te Ligjit nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore, Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, nenit 150 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

**URDHEROJ:**

1. Zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise "Prodhim Mobilje" Sh.a. Tirane ne masen 1,770,000 leke e barabarte me 1,770 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili, qe i perkasin vleres se ish "godines se byrose se studimeve dhe projektimeve te industrise sedrurit".
2. Kapitali i shoqerise "Prodhim Mobilje" Sh.a. Tirane behet 45,536,000 leke, i barabarte me 45,536 aksione me vlere nominale 1,000 leke secila.Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise "Prodhim Mobilje" Sh.a. Tirane
3. Ngarkohet Drejtoria e shoqerise "Prodhim Mobilje" Sh.a. Tirane, per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**Anastas ANGJELI**
**MINISTER**

N. 65 dt. 13.7.09

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

# URDHER

Nr 622 Date 08/07/2009

**PER**

**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PRODHIM MOBILJE " TIRANE**

Drejtuar: SH.A "PRODHIM MOBILJE " TIRANE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te Sh.a "Prodhim Mobilje" Tirane,

**URDHEROJ:**

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 9 227 000 leke , i barabarte me 9 227 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqerise behet 36 309 000 leke, i barabarte me 36 309 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
3. Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit te shoqerise.
4. Bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqerise " Prodhim Mobilje" Tirane per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES MINISTRI TIRANE

**MINISTRI**

**GENC RULI**

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: kabinet@mete.gov.al
Internet: http://www.mete.gov.al

Tel: +355 4 226241
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

Nr. 68 dt. 18.8.09

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

# URDHER

Nr. 671 Date 13.08.2009

## PER

## ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PRODHIM MOBILJE " TIRANE

Drejtuar: SH.A "PRODHIM MOBILJE " TIRANE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te Sh.a "Prodhim Mobilje" Tirane,

**URDHEROJ:**

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 130 932 366 leke , i barabarte me 130 932 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqerise behet 167 241 366 leke, i barabarte me 167 241 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
3. Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit te shoqerise.
4. Bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqerise " Prodhim Mobilje" Tirane per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

**MINISTRI**

**GENC RULI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES TIRANE


Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr 2
E-mail: [illegible]
Internet: http://www.mete.gov.al
Tel: +355 4 226241
Tel: +355 4 223156
Fax: +355 4 234052

N 63 dat 24.8.09

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES**
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE**
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE**

# URDHER

Nr 676 Date 20.08.2009

**PER**

**PERGATITJEN E DOKUMENTACIONIT PER NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE**

Drejtuar: Sh.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, si dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te sh.a "Prodhim Mobilje" Tirane.

**URDHEROJ:**

1. Ndryshimin e kapitalit te Sh.A "Prodhim Mobilje" Tirane per zvogelimin e vleres se objektit "Magazina e Repartit te Montimit" me siperfaqe te pergjithshme 1 532 m2.
2. Eksperţja Kontabel e Autorizuar Zj. Mimoza Memoçi te pergatise raportin perkates ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij urdheri Drejtoria e Sh. A. " Prodhim Mobilje " Tirane .

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

**MINISTRI**

**GENC RULI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE DHE ENERGJETIKES TIRANE

Nr.81 dd. 12.10.2011

2 kopje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001, Faqja web: http://www.mete.gov.al

**URDHËR**

Nr.754 Datë 10.10.2011

**PER**

**PERGATITJEN E DOKUMENTACIONIT PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE**

Drejtuar: Sh.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, si dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit te vetëm te sh.a "Prodhim Mobilje" Tirane,

**URDHEROJ:**

1. Zvogëlimin e kapitalit te Sh.A "Prodhim Mobilje" Tirane për objektin "Reparti Mekanik" ne administrim te sh.a " Prodhim Mobilje" Tirane.
2. Ekspertja Kontabël e Autorizuar Zj. Mimoza Memoçi te përgatisin raportin përkatës ne përputhje me piken 1 te këtij urdhri.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Sh. A. " Prodhim Mobilje " Tirane .

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**NASIP NAÇO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: http://www.mete.gov.al

8027/1 01.12.2011

# URDHËR

Nr. 980 Datë 01.12.2011

PER

ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE
Drejtuar: SH.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a "Prodhim Mobilje" Tirane,

URDHËROJ:

1. Kapitali Themeltar të zvogëlohet për vlerën 11 402 000 leke , i barabartë me 11 402 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 118 758 000 lekë, i barabartë me 118 758 aksione me vlere nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Prodhim Mobilje" Tirane për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TIRANË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**
**Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike**
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: http://www.mete.gov.al

**Nr. 9413/1 Prot.** **Tiranë, më 12 . 1 . 2012**

**Drejtuar : SH.A "PRODHIM MOBILJE"**

**TIRANE**

**Lënda :** Miratohet statuti i shoqërisë "Prodhim Mobilje" Tirane.

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria " Prodhim Mobilje" Tirane, dërguar me tuaj shkresën nr. 113 date 21.12.2011, konstatojmë se ai është hartuar ne zbatim te dispozitave te nenit 230 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Për këto arsye bazuar ne nenin 102, pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne ligjin Nr. 7926, date20.04.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin nr. 1195, date 14.08.1995,Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, nenit 216 e ne vijim te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë Tregtare", aksionari shtet i cili zotëron 100% te aksioneve te Sh.a "Prodhim Mobilje" Tirane, miraton statutin e ri te shoqërisë.

Ngarkohet " Prodhim Mobilje" Tirane, për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, Regjistrimi fillestar, neni 32,36.

**MINISTRI**

**NASIP NAÇO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TIRANE

31
dt. 3.4.2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E PERGJITHSHME E OFRIMIT TE SHERBIMEVE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: http://www.mete.gov.al

# URDHËR

Nr. 207 Datë 3.4.13

## PER

PERGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TE ZVOGELIMIT TE KAPITALIT NE SH.A " PRODHIM MOBILJE " TIRANE

Drejtuar: SH.A "PRODHIM MOBILJE", TIRANE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a "Prodhim Mobilje " Tirane,

## URDHËROJ:

1. Zvogëlimin e kapitalit te shoqërisë "Prodhim Mobilje" Tirane, per vlerën e objektit "Reparti i Montimit", me sipërfaqe 1 905 m2.
2. Ekspertja Kontabël e Autorizuar Zj. Anita Pulaj te përgatisë raportin e zvogëlimit te kapitalit.
3. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Prodhim Mobilje" Tirane, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**EDMOND HAXHINASTO**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OFRIMIT TE SHERBIMEVE**
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE**

**URDHËR**

**Nr.** 302 **Datë** 19. 4. 2013

**PER**

ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A " PRODHIM MOBILJE " TIRANE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe urdhrit Nr. 207 date 03.04.2013, me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a "Prodhim Mobilje " Tirane,

**URDHËROJ:**

1. Kapitali Themeltar të zvogelohet për vlerën 43 549 000 leke , i barabartë me 43 549 aksione me vlere nominale 1000 leke secila qe i përket vlerës se objektit " Reparti i Montimit me sipërfaqe 1 905 m2.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 75 209 000 lekë, i barabartë me 75 209 aksione me vlere nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Prodhim Mobilje" Tirane për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**FLORJON MIMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

Nr. 1355/4 Datë 2.4.2015

## PËR

## ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SH.A " PRODHIM MOBILJE" TIRANË

**Drejtuar: SH.A "PRODHIM MOBILJE" TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Urdhrit të MZHETTS Nr. 1355/1, datë 13.3.2015, me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a " Prodhim Mobilje " Tiranë.

## URDHËROJ:

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 932 000 lekë, i barabartë me 932 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 76 141 000 lekë, i barabartë me 76 141 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Prodhim Mobilje" Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ARBEN AHMETAJ

Aplikanti
Xhemal Baba

*Auditues ligjor (Eksperte Kontabel e Rregjistruar)*
*Anita Pulaj, License Nr 155, datë 08.06.2006*

Shoqëria
Dokument Origjinale

# RAPORT

## PER VLERESIMIN E ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR

## TE SHOQERISE « PRODHIM MOBILJE» SH.A

**TIRANE**

# PERMBAJTJA

Raporti i Ekspertit Kontabel te Regjistruar

*Bashkangjitur raportit jane dokumentat si me poshte :*

- Raporti i ekspertit vleresues
- Plan vendosja e pasurise 3/166
- Urdheri i MZHETS Nr. 2027/7 date 31/05/2017
- Pasqyrat financiare te vitit 2016

**RAPORT**
**PER VLERESIMIN E ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR TE SHOQERISE**
**« Prodhim Mobilje» sh.a**

**Drejtuar: Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes**

**Shoqerise « Prodhim Mobilje» sh.a**
**Tirane**

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, te caktuar me Urdherin Nr. 2027/7 date 31/05/2017, te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes, kemi kryer proceduren per vleresimin e zmadhimit te kapitalit shoqerise.

**Baza ligjore per realizimin e ketij misioni eshte:**

- Ligji Nr. 7850, date 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- Ligji Nr. 9228, date 29/04/2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare".
- Ligji Nr. 10091, date 05/03/2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar".
- Ligji Nr. 9723, date 05/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- Urdheri Nr. 2027/7 date 31/05/2017 i Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes.

Pergjegjesia e drejtimit te shoqerise "Prodhim Mobilja" sh.a eshte : Pergatitja dhe paraqitja e drejte e deklarimeve financiare, juridike dhe informacioneve te tjera te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit te vleresimit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise.

**Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi zmadhimin e kapitalit te Shoqerise "Prodhim Mobilje" sha, per vlerat te dala si rezultat i kalimit te objektit « Magazine prane qytetit te nxeneseve, me siperfaqe totale 4378 m2 ».**

Shoqeria "Prodhim Mobilja" eshte themeluar ne date 10/11/1998 si Shoqeri Anonime me kapital te regjistruar aktual 76,141,000 leke, me aksioner te vetem Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes, me seli ne Tirane. Aktiviteti i shoqerise prane rregjistrit tregtar eshte "Prodhim mobilje e orendi prej lende druri", ne fakt shoqeria ushtron aktivitet ne qeradhenie dhe privatizim objektesh.

Raportin e vleresimit te zmadhimit te kapitalit e mbeshtesim ne pasqyrat financiare te vitit 2016, meqenese Pasqyrat financiare te vitit 2017 nuk jane mbyllur ne daten e hartimit te ketij raporti.

*Ne daten e hartimit te ketij raporti nuk eshte mare parasysh rezultati nga datat 01/01/2017 deri ne 30/06/2017*
Zmadhimi i kapitalit vjen si rezultat i shtimit te aktiveve te shoqerise, nga te cilat me poshte po sqarojme pozicionet e aktivit dhe te pasivit te pasqyrave financiare te vitit 2016.

Pasqyrat finnciare te vitit 2016 jane te audituara dhe te miratura nga MZHETTS. Bazuar sa me siper po japim nje analize me te detajuar te grupit te aktiveve dhe grupit te kapitalit te cilat kane te bejne me zbatimin e urdherit.

*Grupi i Aktiveve afatgjata materiale ne date 31/12/2016 eshte si me poshte:*

| **Aktivet afatgjata materiale** | **2016** | **2015** |
|---|---|---|
| Toke dhe ndertesa | 59,524,087 | 59,524,087 |
| Makineri e pajisje | 300,465 | 300,465 |
| Te tjera pajisje | 178,950 | 178,950 |
| **Totali** | **60,003,502** | **60,003,502** |

***Grupi i kapitaleve te veta ne date 31/12/2016 eshte si me poshte:***

| **Kapitali dhe rezervat** | **2016** | **2015** |
|---|---|---|
| Kapitali I nenshkruar | 76,141,000 | 76,141,000 |
| Rezerva rivleresimi | 1,094,438 | 1,094,438 |
| Humbje e mbartur | (14,784,019.00) | (14,891,636.00) |
| Humbje e fitime te vitit | (7,145,993.00) | 107,617.00 |
| **Totali** | **55,305,426** | **62,451,419** |

**Nga verifikimet e kryera na rezultoi se:**
**Kapitali i regjistruar ne shumen 76,141,000 leke perputhet me ekstraktet e QKR-se.**

**Zmadhimi i grupit te kapitalit te shoqerise "Prodhim Mobilja" sh.a**

Ne zbatim te Urdherit Nr. 2027/7 date 31/05/2017 kapitali i shoqerise zmadhohet me vleren e objektit « Magazine prane qytetit te nxeneseve, me siperfaqe totale 4378 m2 »
Ne vitin 2011, ky objeket eshte pjese e grupit te objekteve "Magazinat e Qytetit te Nxenesve" Tirane, me siperfaqe totale 9100 m2 dhe siperfaqe ndertimi 1708.11 m2 ne administrim te "Korporates Elektroenergjitike Shqiptare' "Kesh" sha.
Shoqeria "Kesh" sha, me shkresen nr.4544/2 date 01/10/2011 dhe me Vendim te Keshillit Mbikqyres nr.30 date 03/10/2011, i drejtohet aksionerit per zvogelimin e kapitalit te shoqerise me nje grup objektesh (ku eshte i perfshire dhe objekti i mesiperm) qe nuk i sherbejne aktivitetit te saj.
Aksioneri me urdher nr.815 date 17/10/211, urdheron zvogelimin e kapitalit te shoqerise "Kesh" sha.
Mbas perfundimit te procedurave te zvogelimit te kapitalit te shoqerise "Kesh' sha keto pasuri i kalojne ne ruajtje shoqerise "OST' sha.

- Me urdherin nr.2027/3 date 05/05/2017 i Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes, objekti 2-kate, ku siprfaqja e truallit eshte percaktuar 4378 m2 (bashkangjitur plan vendosjen e miratuar), me siprfaqe ndertimi per 1083 m2, i kalojne ne administrim shoqerise « Prodhim Mobilja » sha

- Me urdhrin nr.2027/7 date 31/05/2017 eshte vendosur kryerja e procedurave per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me vleren e objektit te percaktuar ne urdhrin nr.2027/3 date 05/05/2017.

Objekt nga viti 2011 ka qene ne ruajtje, me se fundmi nga shoqeria « OST » sha, per te cilin nuk jane bere procedurat e vleresimit apo te zhvleresimit te kesaj pasurie, pasi nuk ka qene pjese ne pasqyrat financiare te kesaj shoqerie.
Nga inspektimi ne vend qe i eshte bere prones eshte kostatuar se siperfaqa per 734 m2 eshte e zene me shtepi private.
Bazuar ne ligjin Ligji Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", meqenese zmadhimi i kapitalit te shoqerise do behet me vleren e ketij objekti, dmth me kontribute ne natyre, kemi kontraktuar ekspert vleresues per percaktimin e vleres se ketij objekti.

Bazuar ne raportin e ekspertit vleresues vlera e objektit eshte:
- Vlera e truallit eshte 91,570,249 leke
- Vlera e nderteses eshte 38,255,751 leke
- Total prona eshte 129,826,000 leke

Meqenese kjo pasuri i kalon shoqerise, veprimet ne kontabilitetin e shoqerise, pas kryrjes se procedurave ligjore per zmadhimin e kapitalit jane:
1. Zmadhimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise ne shumen 129,826,000 leke
2. Shtim te zerit "Aktive afatgjata materiale" toke per ne shumen 91,570,249 leke.
3. Shtim te zerit "Aktive afatgjata materiale" ndertese per ne shumen 38,255,751 leke.

**Kapitali i regjistruar i shoqerise, zmadhohet me kontribute ne natyre per 129,826,000 leke.**
**Efekti i ndryshimeve te kapitalit te regjistruar eshte si me poshte:**

- **Kapitali i regjistruar para zmadhimit ne QKR.......................... 76,141,000 leke**
- **Kapitali i regjistruar zmadhohet per .........................................129,826,000 leke**
- **Kapitali i regjistruar pas zmadhimit ..................................... 205,967,000 leke**

**Kapitali i regjistruar i shoqerise "Prodhim Mobilja" sh.a Tirane pas zmadhimit eshte 205,967,000 leke (dyqindepesemilion e nenteqindegjashtedhjeteshtatemije), cili perbehet nga 205,967 aksione me vlere 1,000 leke secila.**
**Ky kapital zoterohet 100% nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarjes.**

**Theksojme se kapitali i shoqerise zmadhohet me kontribute ne natyre per 129,826,000 leke (bashkangjitur raporti i ekspertit vleresues per pasurine)**

Ne perfundim te misionit qe na eshte caktuar, duke kryer te gjitha ekzaminimet e nevojshme, pasi verifikuam te gjitha procedurat per zmadhimin e kapitalit raportojme se e kemi plotesuar kete detyre sipas kerkesave ligjore ne fuqi.
Ky raport mbahet ne 4 (kater) kopje te njejta.

**Auditues Ligjor (Ekspert kontabel i rregjistruar)** **Tirane me 27/06/2017**

**Anita Pulaj** (pulaj_anita@yahoo.com; cel:0692087743)

Ekspert Kontabel e Autorizuar
Anita PULAJ
NUIS K31512115F
Liçence Nr.155
TIRANA - ALBANIA

# RAPORT VLERËSIMI

**Objekti**

**Truall me sipërfaqe 4378 m$^2$, nga të cilat Ndërtesë 2-kat me sipërfaqe 1083 m$^2$ , me numër pasurie 3/166, Rruga "Konferenca e Pezës", sot rruga" Hamdi Pepo", Tiranë.**

**Porositës : EKA. Znj.Anita Pulaj**

**Për llogari të : MZHETTS,**

**Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore**

**Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore.**

**PËRGATITI / PREPARED BY:**
**Evendum Albania sh.p.k**
***Nr. NIPT / NUIS No:L32202053B***
***Nr. Liç: Vp / Licensë Vsh0922***

EVENDUM
L32202053B
Sh.p.k

RAPORT VLERËSIMI

**Përmbajtje e Raportit të Vlerësimit**


**Kapitulli I - Instruksione**

1.1 Data e Vlerësimit dhe Inspektimit

1.3 Bazat e vlerësimit

**Kapitulli II - Vendndodhja dhe përshkrimi i pronës**

2.1 Vendndodhja e pronës

2.2 Përshkrimi i pronës

2.3 Të dhënat e pronës / Pronësia

2.4 Infrastruktura e zonës

**Kapitulli III - Vlerësimi**

3.1 Qëllimi i vlerësimit të pronës

3.2 Vështrim i pëgjithshëm mbi tregun

3.3 Kushte dhe supozime të konsideruara në raport

3.4 Metodologjia e Vlerësimit

**Kapitulli IV- Komente dhe konkluzione**

4.1 Komente dhe konkluzione

**Kapitulli V- Lidhjet e raportit**

5.1 Fotografi të pronës

5.2 Foto ajrore të pronës, pozicioni gjeografik

5.3 Planvendosja e pronës dhe planimetri e saj

5.4 Dokumentacioni ligjor

RAPORT VLERËSIMI

**KAPITULLI I**
**Instruksione**

**1.1 Data e vlerësimit**

Prona u inspektua me datë **01 Qershor 2017**. Raporti u përgatit dhe dorëzohet me datë **20 Qershor 2017**.

**1.2 Instruksione instruksione**

Vlerësimi është bërë në zbatim të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr.926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e Vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" dhe UKM Nr.5222datë 26.06.2015 për zbatimin e e kësaj VKM dhe akteve te tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Raporti si i tërë apo pjesë të tij janë rreptësisht konfidencial pasi ai është përpiluar vetëm për llogari të porositësit për qëllimin e sipërcituar. Ai nuk mund të përfshihet në asnjë dokument të shkruar, qarkore apo deklaratë dhe as nuk mund të publikohet pa miratimin tonë me shkrim. Ai mund të jetë subjekt ndryshimesh pas deklaratës tonë me shkrim. "Evendum Albania" shpk nuk njeh përgjegjësi ndaj palëve të treta që mund të përdorin këtë raport.

Ky raport vlerësimi hartohet sipas parimeve të përgjithshme të vlerësimit në përputhje me Manualin e Standarteve Europiane për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme, si dhe me legjislacionin vendas dhe vendimet në fuqi. Ai mbështetet në dokumentacion ligjor që më është vënë në dispozicion, në inspektimin e pronës në terren, kushtet konkrete dhe gjendjen faktike të saj.

Vlerësimi i bërë merr parasysh Vlerën e Tregut të Lirë dhe ka për bazë vlerën që ka prona në momentin e kryerjes së këtij vlerësimi. Në përputhje me të dhënat, me inspektimin dhe gjykimet tona, kemi përgatitur vlerësimin e mëposhtëm për përcaktimin e vlerës sa më reale të pronës. Me sa jemi në dijeni, nuk kemi asnjë konflikt interesi në përgatitjen e këtij raporti.

**1.3 Baza e vlerësimit**

Qëllimi i vlerësimit është gjetja e Vlerës së Tregut të Lirë të pronës së sipërcituar në momentin e kryerjes së vlerësimit, duke u bazuar në Standartet Europiane të Aprovuara për Vlerësimin e Pasurive, Rekomandimeve të Grupit Europian të Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme i njohur si **TeGOVA.**

Raporti është hartuar duke pasur parasysh instruksionet tuaja në lidhje me pronën, dokumentacionin ligjor dhe teknik për përcaktimin me saktësi të sipërfaqes së secilës pronë,

- Shkresa Nr. 4701/1. datë 23.05.2017 e Agjensisë së Trajtimit të Pronave,
- Genplani i punuar nga Ing. Hajrulla Reçi, i miratuar nga Ministria e Zvillimit, Ekonomisë,Turizmit, Tregtisë dhe Mirëmbajtjes, ministri Znj.Milva Ekonomi.
- Urdhëri nr.2027/7,date 31.05.2017 për përgatitjen dokumentacionit për zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" Sha.
- Inspektimi, verifikimi, matjet dhe fotografimi i objektit, realizuar në terren në prezencë të përfaqësuesve të pronës.

Vlerësimi është bërë sipas parimeve të përgjithshme të vlerësimit që aplikohen edhe në vendet europiane, në përputhje me Manualin e Standarteve Europiane të Vlerësimit.

Vlerësimi është kryer në perputhje me metodologjine e vlerësimit të aseteve shtetërore, të vendosura nga Komiteti Ndërkombetar i Standarteve të Vleresimit të Aseteve (IVSC), sipas kritereve të përcaktuara nga

RAPORT VLERËSIMI

**TEGOVA (Grupi europian i vlerësuesve të Pasurive të Paluajtëshme)**, që është Korporata e vendosjes së Standarteve të vlerësimit të pronave brenda **Komunitetit Europian.**

Objekti "Magazina pranë qytetit të Nxënësve , me sipërfaqe totale 4378 $m^2$ " në administrim të Albafilm Sha Tiranë, do të vlerësohen duke marrë në konsideratë gjëndjen fizike të tyre në momentin e tjetërsimit sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim shoqëruar me fotografitë përkatëse dhe do të kem për bazë vlerën aktuale të tregut që ka prona që vlerësohet në momentin e tjetërsimit (VKM Nr.322 datë 18/04/2013 Neni 1, VKM Nr.926, datë 29.12.2014, UKM Nr.5222 datë 26.06.2015).

Duke patur parasysh dhe analizuar gjithë dokumentacionin ligjor dhe teknik që më është vënë në dispozicion, gjëndjen fizike të objektit, amortizimin fizik–mjedisor, në lidhje me objekttin dhe pasi kemi bërë kërkimet e nevojshme, kemi kënaqësinë t'ju raportojmë si më poshtë:

---

## KAPITULLI II
## Vendndodhja dhe përshkrimi i pronës

---

### 2.1. Vendndodhja e pronës

Pasuria, objekt i këtij vlerësimi, është:
**Truall** me sipërfaqe **4378$m^2$**, dhe Ndërtesë 2-kat me sipërfaqe **1083$m^2$** me nr.pasurie **3/166**, Zona kadastrale 8240, rruga "Konferenca e Pezës" sot rruga "Hamdi Pepo",Tiranë. (Ambjente të Sh.A Prodhim Mobilje)

Prona ndodhet në jug të rrugës "Hamdi Pepo", rreth 2.6 km në jugperëndim të qendrës së Tiranës. Rreth 600m në veri të pronës ndodhet Ura e Lumit Lana ( Pallati me Shigjeta), ku kalon rruga e "Kavajës" dhe po në këtë drejtim në distancë rreth 180m kalon "Unaza e Madhe" ose siç quhet ndryshe rruga "Teodor Keko". Në veriperëndim të pronës në distancë rreth 300m ndodhet Tregu ushqimor (Qyteti i Nxënësve), Shkolla 9vjeçare "1 Qershori" , Shkolla e mesme profesionale elektrike "Gjergj Canco". Në jugperëndim ndodhen shkolla e mesme profesionale e ndërtimit "Karl Gega" dhe godina kolegjit "Turgut Ozal".

**Zona** përreth pronës është mikse me karakter të përzier rezidencial, komercial, institucional, etj. Kjo është një zonë e mirëstrukturuar, me infrastrukturë të sistemuar veçanërisht vitet e fundit, me pozicion të mirë gjeografik, me ndërtime të moshave, tipologjive dhe lartësive të ndryshme. Në të zhvillohen si objekte të ndërtuara para viteve '90, ( objekte industriale dhe arsimore) edhe objekte të ndërtuara pas viteve '90 dhe pas viteve 2000; si objekte të ulëta të tipit vilë me lartësi mesatare 2-3 kate, ashtu dhe objekte të larta banimi dhe shërbimi me lartësi mesatare 8 kate.
Në zonë konstatohet intensitet i lartë ndërtimi dhe densësi e lartë banimi. Në të ofrohen shumëllojshmëri shërbimesh si banesa, magazina, institucione arsimore, etj.

Distancat ajrore të pasurisë së vlerësuar nga pika kryesore referimi janë:

| | |
|---|---|
| Në verilindje: | **Qendra e Tiranës**, rreth 2.6km. |
| Në veri: | **Ura e Lanës, Pallati me Shigjeta** rreth 600m; |
| Në veri- perëndim: | **Tregu Ushqimor ( Qytet i Nxënësve)** , rreth 300m |
| Në jug: | **Zona e Selitës**, rreth 50m |

Distancat ajrore të pasurisë së vlerësuar nga rrugët kryesore automobilistike:

| | |
|---|---|
| Ne veri : | **Rr. "e Kavajës",** 600m |
| Ne lindje: | **Unaza e Madhe,** rreth 400m |
| Ne perëndim : | **Rr."Hamdi Pepo",** buzë rruge |
| Ne jug: | **Rr. "David Selenica"** rreth 80m |

## 2.2. Përshkrimi i pronës

Në pronë nuk janë bërë vëzhgime strukturale dhe komentet tona përfshijnë një inspektim sipërfaqësor të saj. Në të janë kryer matje të ambjenteve dhe fotografi, të cilat janë pjesë integrale e këtij raporti. Nga investigimi i pronës, rezulton se kjo e fundit, është në kushtet si më poshtë:

Objekti është ndërtuar rreth vitit 1980' dhe është pjesë e ish Ndërrmarrjes së Prodhimit të Mobiljeve, sot shoqëria" Prodhim Mobilje"sh.a.

**Aksesi**. Prona ka akses të drejtpërdrejtë me vazhdimin e rrugës dytësore, "Hamdi Pepo", e cila më pas në veri mundëson lidhjen me rrugën kryesore të zonës, rruga "Konferenca e Pezës". Prona aksesohet direkt nga rruga dytësore, në anën veriore.

**TRUALLI**

**Organizimi dhe funksionimi i truallit**

**Trualli** me sipërfaqe **të regjistruar 4378m$^2$,** shtrihet në një reliev me pjerrësi të lehtë në zbritje sipas drejtimit perëndim lindje dhe ka formë thuajse të rregullt gjeometrike në plan. Sipas inspektimit dhe duke ju referuar genplanit të miratuar konstatojmë se sipërfaqja e truallit është e okupuar nga disa ndërtesa private për të cilat nuk mund të shprehemi nëse janë ligjore ose jo. Bazuar në verifikimet e kryera nga hartat kadastrale të zonës, dhe genplanit të miratuar kjo sipërfaqe është rreth 734m$^2$.
Sipërfaqja e zënë me ndërtesë 2 kat është 1083m$^2$, ndërsa sipërfaqja e lirë është në funksion të godinës dhe një pjesë ka shërbyer si shesh për magazinimin dhe vendqëndrimin e automjeteve për transportin e mobiljeve të prodhuara ndërsa pjesa tjetër është në gjëndjen e saj natyrale. Trualli rrethohet nga të gjitha anët me mur me blloqe betoni me lartësi deri në 2m. Hyrja realizohet nëpërmjet një derë metalike me rrëshkitje horizontale e pozicionuar në anën veriperëndimore të tij. Godina e regjistruar është e pozicionuar në anën veriore të tij. Hapësira e okupuar nga shtëpi private është në anën juglindore të truallit me akses nga rruga " David Selenica".

**Ndërtesa ( Ish Magazina te Ndërrmarrjes së "Prodhim Mobilje" Sha, Tiranë )**

**Ndërtesa** referuar dokumentacionit ligjor të vënë në dispozicion, është Ndërtesë 2-kat me sipërfaqe rreth **1083m$^2$**.

Në momentin e inspektimit konstatojmë se një sipërfaqe rreth 220m$^2$ është në përdorim nga një aktivitet privat. Kjo sipërfaqe është e pozicionuar në këndin verior të godinës. Kjo sipërfaqe ka hyrje nga fasada verilindore dhe aksesohet nga një sipërfaqe jashtë truallit objekt vlerësimi.

Objekti ka hyrje kryesore të pozicionuar në anën perëndimore të tij, ku është i pozicionuar edhe kafazi i shkallëve të cilët mundësojnë ngjitjen për në katin e parë të ndërtesës.

Në momentin e inspektimit e gjithë godina është e organizuar në 2 kate:

RAPORT VLERËSIMI

***Kati përdhe***, referuar dokumentacionit ligjor sipërfaqja e këtij kati është **1083m²**, edhe sipas faktit sipërfaqja e tij është po **1083m².** Theksojmë se një sipërfaqe rreth 220m² (ana verilindore) në këtë kat është e ndarë fizikisht dhe përdoret nga persona të tretë . Ky kat është i ndarë në 4 hapësira me hyrje të veçanta. Hapësira e parë është e organizuar në 6 ambjente zyrash dhe 2 nyje higjeno sanitare. Hapësira e dytë me hyrje të pozicionuar në anën juglindore të objektit është e ndarë në 3 ambjente zyra dhe sallë. Hapësira e tretë me hyrje po në fasadën juglindore të objektit është i organizuar në 3 ambjente. Hapësira e 4 dhe e fundit është e shfrytëzuar nga persona të tretë. (Shiko planimetrinë dhe fotografitë në fund të raportit).

***Kati i parë*** i objektit, me sipërfaqe **1083 m².**
Në momentin e inspektimit konstatuam se dera kryesore e katit të parë e cila është e pozicionuar në anën jugperëndimore të objektit është e betonuar dhe nuk mundëm të inspektonim ambjentet e brendëshme të këtij kati. Ngjitja për në këtë kat realizohet nga kafazi i shkallëve të jashtme, të pozicionuara po në këtë fasadë. Sipas informacioneve dhe sipas vëzhgimeve në distancë ambjentet e këtij kati janë një ambjent i vetëm, me ndarje fizike me elementë druri ose me rafte metalike (ndarje të çmontueshme). (Shiko planimetrinë dhe fotografitë në fund të raportit).

**Kushtet ndërtimore**

Objekti i është ndërtuar rreth vitit 1980' por vërehet se herë pas here i është nënshtruar rikonstruksioneve pjesore ndër vite. Ai është në kushte mesatare, me cilësi mesatare punimesh ndërtimore. Konstruksioni i tij është me themele butobetoni, mure mbajtëse me tulla silikat, mbuluar me soletë monolite. Objekti është i ndërtuar mbi një bazament betoni me lartësi rreth 1m. Lidhja vertikale mes kateve realizohet përmes kafazit të shkallëve të jashtme beton/arme. Shkallët janë me bazamakë betoni të derdhur e parapet muraturë tulle . Fasadat e jashtme nuk janë të suvatuara dhe as të lyera.

**Kati përdhe-** Rifiniturat janë në kushte të mira.
- Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyera.
- Dyshemeja në të gjithë sipërfaqen e këtij kati është e shtruar me pllaka gres.
- Dyert kryesore në tre hapësirat jane metalike me llamarinë dhe kangjella metalike.
- Dritaret janë vendosur vitet e fundit dhe janë duroalumini me tek xham.
- Dyert ekzistuese janë duroalumini 1/2 xham.
- Nyjet higjeno sanitare janë të shtruara dhe muret të veshura me pllaka majolike dhe janë të pajisura me elementët e domosdoshëm hidrosanitare.
- Rrjeti i brendshëm elektrik është i lidhur me rrjetin elektrik të zonës,
- Rrjeti i brendshëm hidrosanitar, është i lidhur me rrjetin e Ukz të zonës.

**Kati parë** - Siç u shprehëm edhe më lart nuk mundëm të inspektonim ambjentet e brendëshme të këtij kati. Nuk mund të shprehemi për rifiniturat e brendëshme por nga inspektimi në distancë dhe nga vëzhgimet në fasadat e objektit mund të themi se në këtë kat vihen re amortizime të rifiniturave, të dritareve, etj. Dyshemeja është e shtruar me pllaka çimento që në periudhën e ndërtimit të objektit. Dritaret janë me kasa druri dhe vihet re një masë e madhe amortizimi.

**2.3 Infrastruktura dhe Urbanistika**

Nga një inspektim sipërfaqsor, prona është e pajisur me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme:

**Infrastruktura rrugore**. Nga një inspektim sipërfaqësor, prona ka të gjitha infrastrukturat dhe shërbimet e nevojshme:

**Urbanistika:** Prona ndodhet në zonë pothuajse periferike të qytetit të Tiranës, zonë urbane, e vendosur në pjesën jugperëndimore të qytetit. Komunikimi realizohet nëpërmjet rrugëve dytësore të qytetit të cilat në momentin e inspektimit ishin në gjëndje të mirë , të shtruara me asfalt dhe të pajisura me ndriçim rrugor.
**Infrastruktura elektrike.** Sistemi elektrik i pronës është i lidhur me rrjetin e zonës dhe është supozuar se subjekti në fjalë nuk ka probleme ligjore me entin furnizues.
**Infrastruktura e ujit të pijshëm.** Prona e vlerësuar është e lidhur me sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemin e kanalizimeve dhe është supozuar se subjekti në fjalë nuk ka probleme ligjore me entin furnizues.
**Kanalizimet.** Prona ka sistem të drenazhit që shoqëron gjithë perimetrin e saj.
**Informacion rreth ndotjes së mundëshme.** Bazuar në informacionin e disponuar, rezulton se zona ku ndodhet prona nuk bën pjesë në zonat e ndotura ekologjikisht. Nga inspektimi në terren nuk u konstatua ndonjë faktor potencial për ndotjen ekologjike të tyre.

Nuk kemi bërë investigime të mëtejshme për këto supozime dhe as për përshtatshmërine e këtyre shërbimeve me kushtet teknike të Standartit Europian dhe për pasojë nuk mund të komentojme më shumë.

**3 . Vlerësimi**

Vlerësimi është bërë sipas parimeve të përgjithshme të vlerësimit që aplikohen edhe në vendet europiane, në përputhje me Manualin e Standarteve Europiane të Vlerësimit.

Vlerësimi është kryer në perputhje me metodologjine e vlerësimit të aseteve shtetërore, të vendosura nga Komiteti Ndërkombetar i Standarteve të Vleresimit të Aseteve (IVSC), sipas kritereve të përcaktuara nga **TEGOVA (Grupi europian i vlerësuesve të Pasurive të Paluajtëshme)**, që është Korporata e vendosjes së Standarteve të vlerësimit të pronave brenda **Komunitetit Europian.**

Objekti Truall dhe Ndërtesë pranë qytetit të Nxënësve , me sipërfaqe totale 4378m$^2$, në administrim të "Prodhim Mobilje" Sha Tiranë, do të vlerësohen duke marrë në konsideratë gjëndjen fizike e tyre në momentin e tjetërsimit sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim shoqëruar me fotografitë përkatëse, duke marrë për bazë vlerën aktuale te tregut që ka prona që vlerësohet në momentin e tjetërsimit (VKM Nr.322 datë 18/04/2013 Neni 1, VKM Nr.926, datë 29.12.2014, UKM Nr.5222 datë 26.06.2015).

***Për Truallin:*** Kemi marrë për bazë në këtë raport vlerësimi çmimin e tokës truall duke ju referuar ***Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.89 datë 03/02/2016 për Miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë***. Çmimi i referencës për zonën kadastrale **8240** në qytetin e Tiranës është **20,916 lekë/m$^2$**. Vlera e Truallit më **dt. 20.06.2017,** është marrë rreth **20,916 lekë/m$^2$.**

**Për Ndërtesën:** Për të përcaktuar vlerën e objektit, kemi marrë në konsideratë, Metodën e Kostos së Zëvendësimit të Amortizuar, duke llogaritur koston bruto të objektit në kompleksitetin e tij dhe duke zbritur

format e ndryshme të amortizimit. Vlera me koston e zëvendësimit është një nga metodat e tregut për vlerësimin e një prone.

***Kostoja e zëvendësimit të amortizuar përkufizohet;***

Vlera e kostos së zëvëndësimit të amortizuar është një llogaritje e përafërt e shpenzimeve bruto të zëvendësimit të gjithë ndërtesës, paisjeve e punimeve të infrastrukturës, duke zbritur amortizimin fizik dhe të gjitha format e tjera të mundëshme të amortizimit. Kjo kosto merr parasysh këto zëra;
Kjo kosto merr parasysh këto zëra:

(i) Koston e ndërtesës dhe punimeve të tjera shtesë, të cilat supozohen të jenë të përfunduara në datën e vlerësimit e cila në rastin konkret është 32,113 lekë/m$^2$.( referuar UKM nr.3 datë 28.12.2016 nga EKB)

(ii) Të gjitha shpenzimet e zhvillimit të nevojshme për të krijuar një entitet operacional, përfshirë të gjitha shpenzimet në terren dhe në infrastukturë të cilat janë rreth 8% mbi vlerën e kostos:

(iii) Shpenzimet shtesë për sa i përket tarifave profesionale dhe shpenzimet e tjera për marrjen e liçensave, lejeve, kostoja financiare të cilat përfshijnë rreth 4% mbi vlerën e kostos.

Amortizimin e godinës e kemi marrë sipas rastit nga 30% kati përdhe dhe në masën 60% për katin e parë duke marrë në konsideratë që kati përdhe i është nënshtruar rikonstruksioneve pjesore në vite.

| 1 | 2 | 3 | 4 | (5)=(2)x(3)x(1-4) |
|---|---|---|---|---|
| **Prona** | **Siperfaqe (m2)** | **Vlera (leke/m2)** | **Amortizim(%)** | **Vlera(Leke)** |
| **Ndertesa** | | | | |
| Kati perdhe | 1,083.00 | 32,113 | 30% | **24,344,399** |
| Kati i pare | 1,083.00 | 32,113 | 60% | **13,911,352** |
| **Total (1) - Ndertese** | | | | **38,255,751** |
| **Truall** | 4378.00 | 20,916 | | **91,570,248** |
| **Total (2) - Truall** | | | | **91,570,249** |
| **Grand Total (1+2)** | | | | **129,826,000** |

***Vlera e Truallit është 91.570.249 lekë***
***Vlera e Ndërtesës është 38.255.751 lekë***
***Vlera Totale e Pronës është 129.826.000 lekë***

## 4. Dokumentacioni i përdorur për vlerësim

***Truall 4378m$^2$, nr. pasurie 3/164 dhe ndërtesë 2 kat 1083 me nr.pasurie 3/166, volum -, faqe -, ZK 8240, Tiranë.***

- Genplani i punuar nga Ing. Hajrulla Reçi, i miratuar nga Ministria e Zvillimit, Ekonomisë,Turizmit, Tregtisë dhe Mirëmbajtjes, ministri Znj.Milva Ekonomi.
- Urdhëri nr.2027/7,datë 31.05.2017 për "Përgatitjen dokumentacionit për zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" Sha Tiranë.

– Shkresa me Nr.Prot. 4701/1. datë 23.05.2017 e Agjensisë së Trajtimit të Pronave,

**9. Shënime**

SHËNIME DHE REZERVA

- Kemi marrë të mirëqenë, në bazë të dokumentacionit, të drejtën e plotë të pronësisë nga "Prodhim Mobilje" Sh.a.
- Kemi marrë të mirëqënë gjithë materialin tekniko-ligjor që na është vënë në dispozicion dhe nuk mbajmë përgjegjësi për vërtetësinë ligjore të dokumentacioneve përshkruese të pronës. Gjithashtu është konsideruar se statusi ligjor i pronës nuk ka pësuar ndryshime nga data e lëshimit të dokumentacionit dhe është supozuar se prona nuk ka probleme tekniko-ligjore që do të pengonin zhvillimin apo shitshmërinë e saj.
- Në këtë vlerësim, prona është supozuar e lirë nga kushte të veçanta që mund të ndalojnë zhvillimin e tyre në përdorimin më të mirë. Gjithashtu është marrë i mirëqënë fakti se subjekti posedues i pronës nuk ka detyrime kundrejt enteve përkatëse (NJQV, OSSHE, UKV, etj).
- Vlerës së shitjes së lirë të deklaruar në këtë raport vlerësimi nuk i janë zbritur kostot e shitjes dhe nuk janë përfshirë as tatimet nga të ardhurat e shitjes së pasurisë.
- Inspektimet e kryera kanë qenë sipërfaqësore dhe gjykimet tona janë dhënë në bazë të këtyre vëzhgimeve. Planvendosja është e përafërt dhe ka vetëm funksion orientues.
- Pjesët e mbuluara, të paekspozuara apo të paarritshme nuk janë kontrolluar dhe janë supozuar të padëmtuara.
- Vlerësimi i pronës është bërë në bazë të çmimeve të referencës të miratuara nga institucionet përkatëse në fuqi në përiudhën e vlerësimit Qershor 2017.
- Raporti në fjalë është rreptësisht konfidencial dhe është i kufizuar vetëm me marrësin për qëllimin që ajo i referohet. Ai mund të jetë objekt i ndryshimit ose pikëmbështetje të tjera vetëm pas deklaratës me shkrim. "Evendum Albania" Shpk nuk njeh përgjegjësi ndaj palëve të treta.

**Përgatitur nga:**
***Evendum Albania sh.p.k***
*Rruga "Kajo Karafili"*
*Pallati Bimbashi, Tiranë*

EVENDUM L32202053B Sh.p.k

**Znj.Lindita Konduri-** Vlerësuese e Shkallës së Parë

**Z. Erind Bejleraj-** Vlerësues i Shkallës së Dytë

**Znj.Sonila Tarazhi-** Vlerësuese e Shkallës së Parë




**Makrozonimi i prones ne imazh satelitor**




Mikrozonimi i pronës në imazh satelitor




Planvendosje e Pronës -Imazh satelitor

**FOTOGRAFI TË PRONËS**





**Pamje të Pronës nga Rruga Hamdi Pepo**





**Hyrja për në sheshin e brendshëm të Pronës**










**Kufiri verilindor i truallit**




**Kufiri jugor i truallit**

**Fotografi të katit përdhe**

**Hyrja nga ana jugperëndimore**













**Hyrja nga ana juglindore**













**Hyrja e dyte nga ana juglindore**




















RAPORT VLERËSIMI

**Fotografi të katit parë**











RAPORT VLERËSIMI

**DOKUMENTACIONI LIGJOR**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE**

Rr. "Muhamet Gjollesha" Nr. ... Tiranë. Tel/ Fax ++355 42256831

**Nr._____Prot.** **Tiranë, më___/___/2017**

**Drejtuar:** Prodhim Mobilje SH.A
Adresa: Rr e Kavajës,Ish Kombinati i Drurit "Misto Mame",Tiranë

**Lënda:** Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr.110 prot.,datë 10.05.2017, administruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave me nr. 4701 prot., datë 10.05.2017, me anë të së cilës kërkoni informacion në lidhje me objektin e pasurisë nr. 3/166,ZK 8240,me sipërfaqe prej 4378 m2 për vazhdimin e proçedurave të mëtejshme me MZHETTS-në", Ju bëjmë me dije se:

Referuar arkivës dixhitale pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave nuk rezulton të ketë vendim për njohje, kthim apo kompensim të pronës për pasurinë nr. 3/166,ZK 8240,me sipërfaqe prej 4378 m2.

Përsa i përket objektit të kërkesës suaj në lidhje me pretendimet (*kërkesat e patrajtuara*) të cilat janë pranë Sektorit të Shqyrtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie, sqarojmë se nuk janë të pasqyruara në sistemin e WEB-GIS të ATP-së, kjo për shkak të **mosplotësimit të saktë** sipas kritereve të përcaktuara në ligji të dokumentacionit hartografik nga subjekti kërkues, apo dhe në rast **mospërputhje** ndërmjet dokumentacionit ligjor (*me anë të së cilës pretendon pronën*) me atë hartografik (*pozicionimi me topograf me liçencë*), gjë e cila na çon në një pozicionim të gabuar të pronës.

Në këto kushte ATP-ja e ka të pamundur të jap një përgjigje përfundimtare përsa i përket objektit të kërkesës suaj (*në lidhje me pretendimet*), duke qënë se nuk mund të garantojë një informacion të saktë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

Me respekt

**Sonila Qato**
Drejtor i Përgjithshëm

RAPORT VLERËSIMI

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

Nr. 2027 Datë 31.5.2011

PËR

**PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË**
**DREJTUAR: "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të "Prodhim Mobilje" sha Tiranë;

URDHËROJ:

1. Zmadhimin e kapitalit të "Prodhim Mobilje" Sha Tiranë, për vlerën e objektit "Magazina pranë qytetit të nxënësve, me sipërfaqe totale 4378 m2.

2. Eksperti Kontabël i Autorizuar Znj. Anita [illegible], të përgatisë raportin përkatës në përputhje me pikën 1 të këtij urdhri.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri "Prodhim Mobilje" sha Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MILVA EKONOMI

Bulevardi "Dëshmorët e K[illegible] http://www.ekonomia.gov.al


MINISTRI
MILVA EKONOMI
PER PRODHIM MOBILJE SH.A.
ADMINISTRATORI
PERGATITI :
ING. HAJRULLA RECI
3/163
3/561
3/166
2K
3/152
RRUGA "KONFERENCA E PEZES" ( KAVAJES )

**PLAN -- VENDOSJA E PAS. 3 / 166 SH. 1 : 500**

OBJEKTI: PRONAT E SH.A. PRODHIM - MOBILJE

RRUGA " KONFERENCA E PEZES " ( KAVAJES )

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ,Turizmit ,Tregetise dhe Sipermarrjes

**MINISTRI**

MILVA EKONOMI




**SHENIM:**

Objekt 2-Kat Sip.=1083 m2 Kati

PAS. 3 / 166 S = 4378 m2 TRUALL

Ku nje Sip.= 734 m2 eshte zene me shtepi private

PER PRODHIM MOBILJE SH.A.

**ADMINISTRATORI**

FATMIR CIBAKU

**PERGATITI :**

**ING. HAJRULLA RECI**

*Ing Gjeodet Markshejder*

*HAJRULLA REÇI*

*LIÇ TZ 0571*

MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

**URDHËR**

Nr. 2024/7 Datë 21.5.2011

**PËR**

**PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË**
**DREJTUAR: "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të "Prodhim Mobilje" sha Tiranë;

**URDHËROJ:**

1. Zmadhimin e kapitalit të "Prodhim Mobilje" Sha Tiranë, për vlerën e objektit "Magazina pranë qytetit të nxënësve, me sipërfaqe totale 4378 m2.

2. Eksperti Kontabël i Autorizuar Znj. Anita Pulaj të përgatisë raportin përkatës në përputhje me pikën 1 të këtij urdhri.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri "Prodhim Mobilje" sha Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**MILVA EKONOMI**

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR
EKSPERTËT KONTABËL I REGJISTRUAR
KASTRIOT HAXHAJ NR. LIÇENSËS 22
ILIR DAIU NR. LIÇENSËS 361

TIRANË 29/03/2017

# VËRTETIM

Vërtetojmë se në bazë të kontratës së lidhur midis palëve, kemi në proçesin e auditimit Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 01/01/2016 deri 31/12/2016 të Shoqërisë "PRODHIM MOBILJE " SHA , Tiranë, Rr. Koferenca e Pezëz, me NIPT : J61827055V

Pasi të përfundojmë auditimin e këtyre pasqyrave Financiare do t`ju dërgojmë në rrugë zyrtare, Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare për ushtrimin e mbyllur më datë 31/12/2016 të shoqërisë "PRODHIM MOBILJE " SHA, Tiranë.

Faleminderit për mirëkuptimin !

EKSPERTËT KONTABËL TË REGJISTRUAR

KASTRIOT HAXHAJ

ILIR DAIU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DK AUDIT
SH.P.K.
L62109018C
Bul. Gjergj Fishta, P. 8, Ap 10, Tirane

SHOQERISE "PRODHIM MOBILJE" SH.A TIRANE

# RAPORT I AUDITUESEVE TE PAVARUR MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Periudha 01. Janar deri me 31. Dhjetor. 2016

EKSPERT KONTABEL TE REGJISTRUAR

ILIR DAIU

KASTRIOT HAXHAJ

## RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

## ORTAKUT TE VETEM

## TE SHOQERISE "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANE

### Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **PRODHIM MOBILJE SHA TIRANE**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shenime te tjera lidhur me to.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te pergatitura, me nje besueshmeri te aresyeshme japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per pozicionin financiar te shoqerise **PRODHIM MOBILJE SHA TIRANE**, me 31 Dhjetor 2016, te performances financiare dhe flukseve te parave per ushtrimin e mbyllur, ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare" dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të).

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin

REPUBLIKA E SHQIPERISE DK AUDIT SH.P.K. L62109018C Bul. Gjergj Fishta, P.5, Ap 10, Tirane

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI AKSIONARE"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) | J61827055V | | | |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/03/1993 | | | |
| 3. Emri i Subjektit | Prodhim Mobilje | | | |
| 4. Forma ligjore | Shoqëri Aksionare | | | |
| 5. Data e themelimit | 10/11/1998 | | | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 10/11/1998 Deri: | | | |
| 7. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE KAVAJES | | | |
| 8. Kapitali | 76.141.000,00 | | | |
| 9. Vlera e kapitalit të shlyer: | 36309000.0000 | | | |
| 10. Numri i aksioneve: | 76.141,00 | | | |
| 10.1 Vlera nominale: | 1.000,00 | | | |
| 11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë | të zakonshme | me përparësi | me të drejte vote | pa të drejte vote |
| 11.1 Numri për secilën kategori | | | | |
| 12. Objekti i aktivitetit: | Prodhim mobilje e orendi prej lende druri si: Pajisje zyrash, shkollash, dhoma gjumi, stazhonim, prodhime me porosi dhe material porosites. | | | |
| 13. Sistemi i administrimit | ☐ me një nivel ☒ me dy nivele | | | |
| 14. Administratori/ët | Fatmir Cibaku | | | |
| 14.1 Afati i emërimit | Nga : 23/12/2013 | Deri : 23/12/2019 | | |
| 15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | | | |

Kopje nga web

| | | |
|---|---|---|
| 15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka). | | |
| 16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës*(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)*<br>16.1 Kryetar/anëtar<br>16.2 Afati i emërimit | Zhuljeta Mediu | |
| | Anetar | |
| | Nga : 14/08/2013 | Deri : 14/08/2016 |
| 17. Anëtar i Pavarur<br>17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve<br>17.2 Kushtet e pjesëmarrjes | Po | |
| | Jo | |
| | | |
| 18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| 19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës*(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)*<br>19.1 Kryetar/anëtar<br>19.2 Afati i emërimit | Saimir Suli | |
| | Anetar | |
| | Nga : 19/05/2015 | Deri : 19/05/2018 |
| 20. Anëtar i Pavarur<br>20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve<br>20.2 Kushtet e pjesëmarrjes | Po | |
| | Jo | |
| | | |
| 21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| 22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës*(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)*<br>22.1 Kryetar/anëtar<br>22.2 Afati i emërimit | Arvid Uruçi | |
| | Anetar | |
| | Nga : 24/04/2009 | Deri : |
| 23. Anëtar i Pavarur<br>23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve<br>23.2 Kushtet e pjesëmarrjes | Po | |
| | Jo | |
| | | |
| 24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| 25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar<br>25.1 Afati i emërimit | Esmeralda Balluku | |
| | Nga : 10/11/1998 | Deri : |
| 26. Aksionarët | Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes | |
| 26.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote : 76141.0000<br>Pa te drejte vote : | |
| 26.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 100,00 | |
| 27. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 28. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: PRODHIM MOBILJE | |

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| | Telefon: 042226241 |
| 29. Statusi: | Aktiv |

Lista e Dokumenteve:
Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)
Dokumenti i autorizimit
Vendim i asamblese se pergjithshme

Regjistrimi Fillestar:

Datë :26/06/2017

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin e shoqerise, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqerisë.

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e aresyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të aresyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në keto pasqyra financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

AUDITUESIT LIGJOR

ILIR DAIU KASTRIOT HAXHAJ

Tirane me 14 04.2017

| | |
|---|---|
| Emertimi dhe Forma ligjore | PRODHIM MOBILJE SHA |
| NIPT -i | J61827055V |
| Adresa e Selise | RRUGA KAVAJES (ISH KOMBINATI MISTO MAME) TIRANE |
| Data e krijimit | |
| Nr. i Regjistrit Tregetar | |
| Veprimtaria Kryesore | DHENIE AMBJENTESH ME QERA |

# PASQYRAT FINANCIARE

( Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe
Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare )

# Viti 2016

| | | |
|---|---|---|
| Pasqyra Financiare jane individuale | | PO |
| Pasqyra Financiare jane te konsoliduara | | |
| Pasqyra Financiare jane te shprehura ne | | LEKE |
| Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne | | |
| Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare | Nga | 01.01.2016 |
| | Deri | 31.12.2016 |
| Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare | | 28/03/2017 |

PRODHIM MOBILJE SHA TIRANE

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| Nr | A K T I V E T | Shenimet | 2016 | 2015 |
|---|---|---|---|---|
| | **Aktivet Afatshkurtra** | | | |
| | ▶ **Aktivet monetare** | 1 | 1,168,669 | 1,729, |
| | 1 *Banka* | | 1,158,571 | 1,726, |
| | 2 *Arka* | | 10,098 | 2, |
| | ▶ **Investime** | 2 | 0 | |
| | 1 *Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit* | 2.1 | | |
| | 2 *Aksionet e veta* | 2.2 | | |
| | 3 *Te tjera Financiare* | 2.3 | | |
| | ▶ **Të drejta të arkëtueshme** | 3 | 7,364,996 | 7,210 |
| | 1 *Nga aktiviteti i shfrytëzimit* | 3.1 | 6,242,002 | 6,080 |
| | 2 *Nga njësitë ekonomike brenda grupit* | 3.2 | | |
| | 3 *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | 3.3 | | |
| | 4 *Të tjera* | 3.4 | 500,000 | 506 |
| | 5 *Kapital i nënshkruar i papaguar* | 3.5 | | |
| | 6 *Të arketueshme nga detyrimet tatimore* | 3.6 | 622,994 | 623 |
| | ▶ **Inventarët** | 4 | 233,239 | 245 |
| | 1 *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme* | 4.1 | 9,562 | 21 |
| | 2 *Inventar i rodhime në proces dhe gjysëmprodukte* | 4.2 | | |
| | 3 *Produkte të gatshme* | 4.3 | 223,677 | 223 |
| | 4 *Mallra* | 4.4 | | |
| | 5 *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)* | 4.5 | | |
| | 6 *AAGJM të mbajtura për shitje* | 4.6 | | |
| | 7 *Parapagime për inventar* | 4.7 | | |
| | ▶ **Shpenzime të shtyra** | 5 | | |
| | ▶ **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara** | 6 | | |
| I | TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA | | 8,766,904 | 9,184 |
| | **Aktivet Afatgjata** | | | |
| | ▶ **Aktive financiare** | 7 | 0 | |
| | 1 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit* | 7.1 | | |
| | 2 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit* | 7.2 | | |
| | 3 *Tituj pronësie në njesitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | 7.3 | | |
| | 4 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | 7.4 | | |
| | 5 *Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata* | 7.5 | | |
| | 6 *Tituj të tjerë të huadhënies* | 7.6 | | |
| | ▶ **Aktivet materiale** | 8 | 60,003,502 | 60,00 |
| | 1 *Toka dhe ndërtesa* | 8.1 | 59,524,087 | 59,52 |
| | 2 *Impiante dhe makineri* | 8.2 | 300,465 | 30 |
| | 3 *Të tjera Instalime dhe pajisje* | 8.3 | 178,950 | 17 |
| | 4 *Parapagime për aktive materiale dhe në proces* | 8.4 | | |
| | ▶ **Ativet biologjike** | 9 | | |
| | ▶ **Aktive jo materiale:** | 10 | 0 | |
| | 1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të ngjashme | 10.1 | | |
| | 2 *Emri i Mirë* | 10.2 | | |
| | 3 *Parapagime për AAJM* | 10.3 | | |
| | ▶ **Aktive tatimore të shtyra** | 11 | | |
| | ▶ **Kapitali i nënshkruar i papaguar** | 12 | | |
| II | TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA | | 60,003,502 | 60,00 |
| | A K T I V E T O T A L E | | 68,770,406 | 69,18 |
| | | | | |
| | LLOGARI JASHT BILANCIT | | 61,573,167 | 61,57 |

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| Nr | DETYRIMET DHE KAPITALI | Shenimet | 2016 | 201 |
|---|---|---|---|---|
| | ▶ **Detyrime afatshkurtra:** | 13 | 13,464,980 | 6,73 |
| | 1 *Titujt e huamarrjes* | *13.1* | | |
| | 2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | 13.2 | | |
| | 3 *Arkëtime në avancë për porosi* | *13.3* | 178,300 | 10 |
| | 4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | 13.4 | 0 | 2 |
| | 5 *Dëftesa të pagueshme* | *13.5* | | |
| | 6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit* | 13.6 | | |
| | 7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | *13.7* | | |
| | 8 *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore* | 13.8 | 775,020 | 29 |
| | 9 *Të pagueshme për detyrimet tatimore* | *13.9* | 156,091 | 12 |
| | 10 *Të tjera të pagueshme* | *13.10* | 12,355,569 | 6,18 |
| | ▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | *14* | | |
| | ▶ **Të ardhura të shtyra** | 15 | | |
| | ▶ **Provizione** | *16* | | |
| | **Totali i Detyrimeve afatshkurtera** | | 13,464,980 | 6,737 |
| | ▶ **Detyrime afatgjata:** | *17* | 0 | |
| | 1 *Titujt e huamarrjes* | 17.1 | | |
| | 2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | *17.2* | | |
| | 3 *Arkëtimet në avancë për porosi* | 17.3 | | |
| | 4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | *17.4* | | |
| | 5 *Dëftesa të pagueshme* | 17.5 | | |
| | 6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit* | *17.6* | | |
| | 7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | 17.7 | | |
| | 8 *Të tjera të pagueshme* | *17.8* | | |
| | ▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | *18* | | |
| | ▶ **Të ardhura të shtyra** | 19 | | |
| | ▶ Provizione: | *20* | 0 | |
| | 1 *Provizione për pensionet* | 20.1 | | |
| | 2 *Provizione të tjera* | *20.2* | | |
| | ▶ **Detyrime tatimore të shtyra** | 21 | | |
| | **Totali i Detyrimeve afatgjata** | | 0 | |
| | DETYRIMET TOTALE | | 13,464,980 | 6,737 |
| | ▶ **Kapitali dhe Rezervat** | *22* | | |
| | ▶ **Kapitali i Nënshkruar** | 23 | 76,141,000 | 76,141 |
| | ▶ **Primi i lidhur me kapitalin** | *24* | | |
| | ▶ **Rezerva rivlerësimi** | 25 | | |
| | ▶ **Rezerva të tjera** | *26* | 1,094,438 | 1,094 |
| | 1 *Rezerva ligjore* | 26.1 | | |
| | 2 *Rezerva statutore* | 26.2 | | |
| | 3 *Rezerva të tjera* | 26.3 | | |
| | ▶ **Fitimi i pashpërndarë** | *27* | -14,784,019 | -14,891 |
| | ▶ **Fitim / Humbja e Vitit** | 28 | -7,145,993 | 107 |
| | **Totali i Kapitalit** | | 55,305,426 | 62,451 |
| | TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT | | 68,770,406 | 69,18 |
| | | | | |
| | LLOGARI JASHT BILANCIT | | 61,573,167 | 61,573 |

## Pasqyra e Performancës
## (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
*Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës*

| Nr | Pershkrimi i Elementeve | Shenimet | 2016 | 2015 |
|---|---|---|---|---|
| ▶ | **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** | 29 | **9,062,699** | **9,806,628** |
| ▶ | **Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces** | 30 | | |
| ▶ | **Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar** | 31 | | |
| ▶ | **Të ardhura të tjera të shfrytëzimit** | 32 | **19,949** | |
| ▶ | **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** | 33 | **-1,022,730** | **-655,681** |
| | 1 *Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme* | 33.1 | -1,022,730 | -655,681 |
| | 2 *Të tjera shpenzime* | 33.2 | | |
| ▶ | **Shpenzime të personelit** | 34 | **-12,717,862** | **-14,261,911** |
| | 1 *Paga dhe shpërblime* | 34.1 | -10,939,539 | -12,398,063 |
| | 2 *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* | 34.2 | -1,778,323 | -1,863,848 |
| ▶ | **Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale** | 35 | | |
| ▶ | **Shpenzime konsumi dhe amortizimi** | 36 | **0** | **-353,416** |
| ▶ | **Shpenzime të tjera shfrytëzimi** | 37 | -2,380,596 | **-4,127,472** |
| | | | | |
| ▶ | **Të ardhura të tjera** | 38 | **0** | **9,939,648** |
| | 1 *Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)* | 38.1 | | |
| | 2 *Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)* | 38.2 | | |
| | 3 *Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)* | 38.3 | | |
| | 4 Subvencione te shfrytezimit | 38.4 | | 700000 |
| | 5 **Te ardhura nga mbylljet e detyrimeve (urdh Min 2013/1 3/7/15)** | 38.5 | | 293964 |
| ▶ | **Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra** | 39 | | |
| ▶ | **Shpenzime financiare** | 40 | **-107,453** | **-233,933** |
| | 1 *Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)* | 40.1 | -47,453 | -225,925 |
| | 2 *Shpenzime të tjera financiare* | 40.2 | -60,000 | -8,00 |
| ▶ | **Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet** | 41 | | |
| ▶ | **Fitimi/Humbja para tatimit** | 42 | **-7,145,993** | **113,863** |
| ▶ | **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | 43 | **0** | **-6,246** |
| | 1 *Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin* | 43.1 | | -6,24 |
| | 2 *Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë* | 43.2 | | |
| | 3 *Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve* | 43.3 | | |
| ▶ | **Fitimi/Humbja e vitit** | 44 | **-7,145,993** | **107,617** |
| ▶ | **Fitimi/Humbja për:** | 45 | | |
| | *Pronarët e njësisë ekonomike mëmë* | 45.1 | | |
| | *Interesat jo-kontrolluese* | 45.2 | | |

## Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

| Nr | Pershkrimi i Elementeve | | 2016 | 2015 |
|---|---|---|---|---|
| ▶ | Fitimi/Humbja e vitit | 46 | **-7,145,993** | **107,617** |
| | Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin: | 46.1 | | |
| | Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja | 46.2 | | |
| | Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale | 46.3 | | |
| | Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje | 46.4 | | |
| | Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet | 46.5 | | |
| ▶ | Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin | 47 | **0** | **0** |
| ▶ | Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin | 48 | **-7,145,993** | **107,617** |
| ▶ | Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për: | 49 | | |
| | *Pronarët e njësisë ekonomike mëmë* | *49.1* | | |
| | *Interesat jo-kontrolluese* | *49.2* | | |

# Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
*(metoda indirekte)*

| | | 2016 | 2015 |
|---|---|---|---|
| ▶ | **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | | |
| | *Fitim / Humbja e vitit* | -7,145,993 | 107,617 |
| | *Rregullimet për shpenzimet jomonetare:* | | |
| | *Shpenzimet financiare jomonetare* | | |
| | *Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar* | | |
| | *Shpenzime konsumi dhe amortizimi* | 0 | 353,416 |
| | *Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale* | | |
| | *Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:* | | |
| | *Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:* | | |
| | *Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera* | -154,459 | 5,553,987 |
| | *Rënie/(rritje) në inventarë* | 11,871 | -18,933 |
| | *Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme* | 6,727,919 | -8,421,955 |
| | | | |
| | **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | **-560,662** | **-2,425,868** |
| ▶ | **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | |
| | *Para neto të përdorura për blerjen e filialeve* | | |
| | *Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve* | | |
| | *Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale* | | -82,667 |
| | *Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale* | | |
| | *Pagesa për blerjen e investimeve të tjera* | | |
| | *Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera* | | |
| | *Dividentë të arkëtuar* | | |
| | **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | **0** | **-82,667** |
| ▶ | **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | |
| | *Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar* | | |
| | *Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral* | | |
| | *Hua të arkëtuara* | | |
| | *Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë* | | |
| | *Riblerje e aksioneve të veta* | | |
| | *Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral* | | |
| | *Pagesa e huave* | | |
| | *Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare* | | |
| | *Interes i paguar* | | |
| | *Dividendë të paguar* | | |
| | **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | **0** | **0** |
| | | | |
| | **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare** | **-560,662** | **-2,508,535** |
| | **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2016** | 1,729,331 | 4,237,866 |
| | *Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare* | | |
| | **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016** | **1,168,669** | **1,729,331** |

# Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

| | | Kapitali i nënshkruar | Primi i lidhur me kapitalin | Rezerva Rivlerësimi | Rezerva Ligjore | Rezerva Statutore | Rezerva të tjera | Fitimet e Pashpërndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali | Interesa Jo-Kontrollues | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ▶ | **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014** | 75,209,000 | | | | | 1,094,438 | - 14,891,636 | | 61,411,802 | | 61,411,802 |
| | Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | | | | | - | | - |
| ▶ | **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015** | 75,209,000 | - | | - | - | - | 1,094,438 | - 14,891,636 | - | 61,411,802 | 61,411,802 |
| | **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | | | | | - | | - |
| | Fitimi / Humbja e vitit | | | | | | | | 107,617 | 107,617 | | 107,617 |
| | **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:** | | | | | | | | | - | | - |
| | **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | | | | | - | | - |
| | **Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:** | | | | | | | | | - | | - |
| | Emetimi i kapitalit të nënshkruar | [illegible] | | | | | | | | 932,000 | | [illegible] |
| | Dividendë të paguar | | | | | | | | | - | | - |
| | **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | | | | | | | | | - | | - |
| | | | | | | | | | | - | | - |
| ▶ | **Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015** | 76,141,000 | - | - | - | - | 1,094,438 | - 14,891,636 | 107,617 | 62,451,419 | | 62,451,419 |
| | Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | | | | | - | | - |
| ▶ | **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016** | 76,141,000 | - | - | - | - | 1,094,438 | - 14,891,636 | 107,617 | 62,451,419 | | 62,451,419 |
| | **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | | | | | - | | - |
| | Fitimi / Humbja e vitit | | | | | | | | - 7,145,993 | - 7,145,993 | | - 7,145,993 |
| | **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:** | | | | | | | | | - | | - |
| | **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | | | | | - | | - |
| | **Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:** | | | | | | | | | - | | - |
| | Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | | | | | - | | - |
| | Dividendë të paguar | | | | | | | | | - | | - |
| | **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | | | | | | | | | - | | - |
| ▶ | **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016** | 76,141,000 | - | - | - | - | 1,094,438 | - 14,891,636 | - 7,038,376 | 55,305,426 | | 55,305,426 |

Referenca

## B Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare

### I AKTIVET AFAT SHKURTERA

### 1 Aktivet monetare

1.1 *Banka*

| Nr | Emri i Bankes | Monedha | Nr llogarise | Vlera ne valute | Kursi fund vitit | Vlera n leke |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | |
| | BKT | LEK | | 304331 | 1 | 304,3 |
| | RZB | LEK | | 849075 | 1 | 849,0 |
| | BKT | USD | | 11.5 | 128.17 | 1,4 |
| | RZB | USD | | 28.8 | 128.17 | 3,6 |
| | Totali | | | | | 1,158,5 |

1.2 *Arka*

| Nr | EMERTIMI | Vlera ne valute | Kursi fund vitit | Vlera n leke |
|---|---|---|---|---|
| | Arka ne Leke | 10098 | 1 | 10,0 |
| | Arka ne Euro | | | |
| | Arka ne Dollare | | | |
| | Pulla tatimore,bileta,te tjera me vlere | | | |
| | Totali | | | 10,0 |

### 2 Investime

2.1 *Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit*

Shoqeria nuk ka tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit

2 *Aksionet e veta*

Shoqeria nuk ka riblerje te aksioneve te emetuara me pare nga ana jone

2.3 *Te tjera Financiare*

Shoqeria nuk ka aktive te tjera financiare te investuara

### 3 Të drejta të arkëtueshme

3.1 *Nga aktiviteti i shfrytëzimit*

| | | |
|---|---|---|
| | Kliente per mallra,produkte e sherbime | 6,242,002 |
| > | Fatura te pa likuiduara nen nje vit | 1,276,402 |
| > | Fatura te pa likuiduara mbi nje vit | 4,965,600 |
| > | Zhvleresimi i te drejtave dhe detyrimeve | |

| **Fatura te pa likuiduara nen nje vit** | **1,276,402** |
|---|---|
| Debitore e kreditore te tjere | 609,693 |
| Brati shpk | 36,684 |
| Doan shpk | 37,650 |
| Skënderbej | 2,375 |
| Parapagim ekspert rivlerësimi TEC Tiranë | 156,000 |
| Shteti detyrime te tjera | 400,000 |
| Artan Cobanaj | 20,000 |
| Fjodor Shtrepi | 14,000 |

| **Fatura te pa likuiduara mbi nje vit** | **4,965,600** |
|---|---|
| Euro Druri | 4,965,600 |

3.2 *Nga njësitë ekonomike brenda grupit*

> *Shoqeria nuk ka te drejta dhe detyrimendaj njesive ekonomike brenda grupit*

3.3 *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*

> Shoqeria nuk te drejta dhe detyrime ndaj njesive ekonomike me interesa pjesëmarrëse

3.4 *Të tjera* 500,000

| | | | |
|---|---|---|---|
| | > *Paradhenje per shpenzime te ndryshme* | | 500,000 |
| | > *Paradhenje paga* | | |
| | **4 Inventarët** | | 233,239 |
| 4.1 | *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme* | | 9,562 |
| 4.2 | *Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte* | | 0 |
| 4.3 | *Produkte të gatshme* | | 223,677 |
| 4.4 | *Mallra* | | 0 |
| 4.5 | *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)* | | 0 |
| 4.6 | *AAGJM të mbajtura për shitje* | | 0 |
| 4.7 | *Parapagime për inventar* | | 0 |
| | **5 Shpenzime të shtyra** | | 0 |
| | **6 Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara** | | 0 |
| | II AKTIVET AFATGJATA | | |
| | **7 Aktivet financiare** | | |
| 7.1 | *Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit* | | 0 |
| 7.2 | *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit* | | |
| 7.3 | *Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | |
| 7.4 | *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | |
| 7.5 | *Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata* | | |
| 7.6 | *Tituj të tjerë të huadhënies* | | |
| | **8 Aktive materiale** | | 60,003,502 |
| 8.1 | *Toka dhe ndërtesa* | | 59,524,087 |
| *8* | *Impiante dhe makineri* | | 300,465 |
| 8.3 | *Të tjera Instalime dhe pajisje* | | 178,950 |
| *8* | *Parapagime për aktive materiale dhe në proces* | | |
| | **9 Ativet biologjike** | | **0** |
| | **10 Aktive jo materiale** | | **0** |
| | **11 Aktive tatimore te shtyra** | | |
| | **12 Kapitali i nenshkruar i pa paguar** | | |
| | III DETYRIMET DHE KAPITALI | | |
| | **13 Detyrime afatshkurtra:** | | |
| *13.1* | *Titujt e huamarrjes* | | **0** |
| 13.2 | *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | |
| *13.3* | *Arkëtime në avancë për porosi* | **178,300** | |
| 13.4 | *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | | |
| *13.5* | *Dëftesa të pagueshme* | | |
| 13.6 | *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit* | | |
| *13.7* | *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | |
| 13.8 | *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore* | **775,020** | |
| | > Paga dhe shpërblime | | **0** |
| | > Paradhënie për punonjësit | | |
| | > Sigurime shoqërore dhe shëndetsore | | **775,020** |
| | > Organizma të tjera shoqërore | | |
| | > Detyrime të tjera | | |
| *13.9* | *Të pagueshme për detyrimet tatimore* | **156,901** | |
| | > Akciza | | |
| | > Tatim mbi të ardhurat personale | **156,901** | |
| | > Tatime të tjera për punonjësit | | |
| | > Tatim mbi fitimin | | |
| | > Shteti- TVSh për t'u paguar | | |
| | > Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore) | | |
| | > Tatime të shtyra (teprica kreditore) | | |
| | > Tatimi në burim | | |

| | | |
|---|---|---|
| 13.10 | *Te tjera të pagueshme* | **12,355,569** |
| | > Ministria e Ekonomise per 30% dhe 70% | 5,884,288 |
| | > Debitore kreditore tjere | 710,429 |
| | > Fonde nga thesari per detyrimet e Komb Tekstil dhe Uzin Mekanike | 5,760,852 |
| | **14 Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | **0** |
| | **15 Të ardhura të shtyra** | **0** |
| | **16 Provizione** | **0** |
| | **17 Detyrime afatgjata:** | **0** |
| | **18 Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | |
| | **19 Të ardhura të shtyra** | |
| | **20 Provizione:** | |
| | **21 Detyrime tatimore të shtyra** | |
| | **22 Kapitali dhe Rezervat** | |
| | **23 Kapitali i Nënshkruar** | **76,141,000** |
| | **24 Primi i lidhur me kapitalin** | |
| | **25 Rezerva rivlerësimi** | **0** |
| | **26 Rezerva të tjera** | |
| 26.1 | *Rezerva ligjore* | **1,094,438** |
| 26.2 | *Rezerva statutore* | |
| 26.3 | *Rezerva të tjera* | |
| | **27 Fitimi i pashpërndarë** | **-14,784,019** |
| | **28 Fitim / Humbja e Vitit** | **-7,145,993** |

## Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve

| | | |
|---|---|---|
| | Te ardhurat perbehen | |
| 29 | • **Dhenje me qera e ambjenteve** | **9,062,699** |
| | **Te ardhura te tjera** | |
| 38.4 | **Subvencione shfrytezimi** | **0** |
| 38.5 | **Te ardhura nga mbylljet e detyrimeve (urdh Min 2013/1 3/7/15)** | **0** |
| | Shpenzimet perbehen nga | |
| 33 | • **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** | 1,022;730 |
| 33.1 | 1 *Lënda e parë dhe materiale (detergjent, kancelari, kompensim shpenzimesh transporti dhe telefoni per Administratorin me vendim Keshilli Mbikqyres)* | 945871 |
| 33.1 | 2 *Të tjera shpenzime* (energji elektrike) | 76,859 |
| 37 | • **Shpenzime të tjera shfrytëzimi** | 2,380,596 |

1 *Sherbime te tjera(llog 618)* 562,419
2 *Shpenzime telefonike (llog 626)* 35,500
3 *Komisjone bankare (llog 628)* 11,953
4 *Shpenzime taksa vendore(llog 634)* 1,103,482
5 *Shpenzime pritje dhe dhurata(654)* 0
6 *Sherbime me personel jasht ndermarjes(621)* 635,628
7 *Gjoba Prodhim Mobilje(6570)* 31,614

42 **10 Fitimi (Humbja) e vitit financiar** -7,145,993

- Fitimi i ushtrimit -7,145,993
- Shpenzime te pa zbritshme

gjoba
demshperblim punonjesi

- Fitimi fiskal
- Humbje mbartura
- Fitimi tatushem

43.1
- Tatimi mbi fitimin

## Pasqyra e Fluksit Monetar - Metoda Indirekte

Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel *1,729,331*

Ne fluksin monetar kane ndikuar

Pozitivisht :

| | |
|---|---|
| Fitimi neto | |
| Amortizimin | 0 |
| Aktive te tjera financiare afatshkurtra | -154,459 |
| Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar | 6,727,919 |
| Shuma e Faktoreve me influence Pozitive | 6,573,460 |

dhe Negativisht :

| | |
|---|---|
| Humbja ushtrimit | -7,145,993 |
| Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme | 0 |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale | 0 |
| Rritje e gjendjes inventareve | 11,871 |
| Dividente te paguar | 0 |
| | |
| Shuma e Faktoreve me influence Negative | -7,134,122 |

Gjendja e Mj.Monetare me 31.12.2016 1,168,669

*cash flow* *1,168,669*

## Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital

- Fitimi (humbja) neto e vitit 2015 107,617
- Shperndarje dividenti 0
- Fitimi qe bartet nga viti I kaluar 0
- Rritja e kapitalit aksioner
- Rivleresime
- Humbje/fitimi I vitit -7,145,993

## Llogarite jashte bilancit

*61,573,167*

> Uzina mekanike Tekstilit 4,159,617
> Kombinati Tekstilit 57,413,550

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
(Anila Petro)

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
(FATMIR CIBAKU)

**Lenda :** **Dorezohet Raporti per Zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise Prodhim Mobilje SHA Tirane**

- **Drejtorit te Shoqerise SHA Prodhim Mobilje Tirane,**

**Zoterinj,**

Bashkelidhur do te gjeni Raportin e Zmadhimit te Kapitalit sipas misionit:

**Objekti i misionit**: Pergatitja e Raportit per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise Prodhim Mobilje sha me vleren e aseteve te dy ndermarrjeve (Kombinati i Tekstileve te Pambukta Tirane dhe Uzina Mekanike e Tekstilit Tirane) nen administrimin e saj.

Raporti dorqzohet ne kater kopje te barazvlefshme.

**Me respekt**

**Tirane me 23 Gusht 2017**

**Eksperte Kontabel e Regjistruar**
**Ludmilla PALUKA**

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
E.K.R. Ludmilla PALUKA
NIPT K71616038S
Licensa Nr. 161
Tirana-Albania

**Licenca Nr 161, date 25.01.2007**
**Nr cel.0692036339**

*EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR*

*Ludmilla PALUKA*
*License Nr 161, datë 25.01.2007*

**Lenda :** **Dorezohet Raporti per Zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise Prodhim Mobilje SHA Tirane**

- **Drejtorit te Shoqerise SHA Prodhim Mobilje Tirane,**

**Zoterinj,**

Bashkelidhur do te gjeni Raportin e Zmadhimit te Kapitalit sipas misionit:

**Objekti i misionit**: Pergatitja e Raportit per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise Prodhim Mobilje sha me vleren e aseteve te dy ndermarrjeve (Kombinati i Tekstileve te Pambukta Tirane dhe Uzina Mekanike e Tekstilit Tirane) nen administrimin e saj.

Raporti dorqzohet ne kater kopje te barazvlefshme.

**Me respekt**

**Tirane me 23 Gusht 2017**

**Eksperte Kontabel e Regjistruar**
**Ludmilla PALUKA**

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
E.K.R. Ludmilla PALUKA
NIPT K71616038S
Liçensa Nr. 161
Tirana-Albania

**Licenca Nr 161, date 25.01.2007**
**Nr cel.0692036339**

Nr 138 Prot
dt. 31/05/2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 4900/1 Prot. Tiranë, më 30.5 2017.

**Lënda:** Miratojmë bilancin kontabël dhe shperndarjen e rezultatit të vitit 2016.

**Drejtuar:** **Z. Fatmir Cibaku**
Administrator,
" Prodhim Mobilje " Sha

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", miratojmë bilancin kontabël dhe shpërndarjen e rezultatit të shoqërisë për vitin 2016.

| | |
|---|---|
| Humbja e vitit ushtrimor | - 7,145,993 lekë |

Humbja e vitit ushtrimor prej – 7,145,993 ( shtatë milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë të mbartet në bilancin kontabël të vitit 2017.

Të merren masa për likuidimin e detyrimeve të ndërmarrjes "Uzina Mekanike e Tekstilit" Tiranë dhe ish "Kombinati i Tekstileve të Pambukta" Tiranë, si dhe çregjistrimi i tyre si subjekte më vete, brenda muajit Dhjetor 2017.

Pas përfundimit të këtij procesi të njoftohet MZHETTS, për fillimin e procedurës së zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" për vlerën e aseteve të dy ndërmarrjeve të mësipërme.

**MINISTRI**

**MILVA EKONOMI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMT EKONOMIK,TURIZMIT,TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
**PRODHIM MOBILJE SH.A.**
**TIRANË**

*Adresa: Rruga e Kavajës, Ish-Kombinati i Drurit "Misto Mame"* *E-mail: prodhim.mobilje@hotmail.com* *tel.04/2350202*

**Nr.214 prot.** **Tiranë më 24/08/2017**

**Lënda:** Kërkohet miratim

**Drejtuar :** Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,Turizmit,Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore Tiranë

Mbështetur në Urdhrin Nr. 609/2 Prot. Datë 05.02.2016 për përgatitjen e dokumentacionit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë, të objektit "TEC" Tiranë kaluar në administrimin tonë dhe në Urdhrin nr. 8125 Prot. Datë 26.10.2015 për përgatitjen e dokumentacionittë zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë me vlerën e aseteve të dy ndërmarrjeve "Kombinati Tekstileve të Pambukta" dhe "Uzina Mekanike e Tekstilit" Tiranë,ju dërgojmë Raportin për Vlerësimin e Zmadhimit të Kapitalit të Regjistruar ("TEC" Tiranë) dhe Raportin e Zmadhimit të Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha ("Kombinati Tekstileve të Pambukta" dhe "Uzina Mekanike e Tekstilit" Tiranë).

Për sa më sipër presim miratimin nga ana juaj për të vazhduar procedurën e regjistrimit të tyre pranë QKB.

**Bashkëngjitur do të gjeni:**

1. Urdhrin Nr. 609/2 Prot. Datë 05.02.2016
2. Shkresën përcjellëse të Ekspertit
3. Raportin për Vlerësimin e Zmadhimit të Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "Prodhim Mobilje"

1. Urdhërin e përbashkët të dy Ministrive: Nr. 2982 date 15.05.2014 të MEI dhe nr. 3901/2 datë 21.10.2014 të MZHETTS
2. Shkresën nr. 3901/7 datë 30.10.2014
3. Shkresën përcjellëse të Ekspertit
4. Raportin për Zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "Prodhim Mobilje"

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin**

**ADMINISTRATORI**

**Fatmir *CIBAKU***

MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

Nr. 609/2 Datë 5-2-16

PËR

## PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË
## DREJTUAR: "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, datë 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit të vetëm të SH.A " Prodhim Mobilje" Tiranë.

URDHËROJ:

1. Zmadhimin e kapitalit të " Prodhim Mobilje " Sha Tiranë, për vlerën e truallit dhe te objektit" " TEC" Tiranë.
2. Zj. Vullnetare Çela të përgatisë raportin e rivlerësimit të truallit dhe të objektit.
3. Pas përfundimit të vlerësimit, Eksperti Kontabël i Autorizuar Z. Neshat Mazaj, të përgatisë raportin e zmadhimit të kapitalit.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri " Prodhim Mobilje" Sha Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR**

*Auditues ligjor (E K R)*
*Neshat Maze*

*Tirane me 22/08/2017*

**Shkrese percjellese**

**Drejtura: Shoqerise « Prodhim Mobilje» sh.a,**
**Tirane**

**Lenda: Dergimi i Raportit Per Vleresimin E Zmadhimit Te Kapitalit Te Regjistruar**

Bashkangjitur ju dergojme 3 kopje origjinale te Raportit per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te regjistruar te shoqerise **"Prodhim Mobilje» sh.a,** nga te cilat:

- 1 kopje per Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregetise dhe Sipermarrjes
- 1 kopje per ta depozituar prane QKB-se
- 1 kopje per Shoqerine.

Raporti per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te regjistruar te shoqerise shoqerohet nga Raporti i Vleresimit i pergatitur nga Ekspertit Vleresues, 1 kopje origjinal + 2 fotokopje te tij.

Pas miratimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregetise, Turizmit dhe Sipermarrjes shoqeria duhet te vazhdoje proceduren ligjore te depozitimit te tij prane Regjistrit Tregtar. (Afati i depozitimit prane QKB-se eshte brenda 30 diteve kalendarike nga data e miratimit te raportit nga MZHETTS)

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Neshat MAZAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

Nr. 609/2 Datë 5-2-16

PËR

## PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË

## DREJTUAR: "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, datë 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit të vetëm të SH.A " Prodhim Mobilje" Tiranë.

URDHËROJ:

1. Zmadhimin e kapitalit të " Prodhim Mobilje " Sha Tiranë, për vlerën e truallit dhe te objektit" " TEC" Tiranë.
2. Zj. Vullnetare Çela të përgatisë raportin e vlerësimit të truallit dhe të objektit.
3. Pas përfundimit të vlerësimit, Eksperti Kontabël i Autorizuar Z. Neshat Mazaj, të përgatisë raportin e zmadhimit të kapitalit
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri " Prodhim Mobilje" Sha Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr.____ prot. Tiranë, më_._.2017

**URDHËR**

**Nr.1039/1, datë 5.9.2017**

**PËR**

**ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË**

**DREJTUAR: SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE " SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Urdhrit Nr. 2027/7, datë 31.5.2016 "Për përgatitjen e dokumentacionit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sh.a Tiranë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë;

**URDHËROJ**

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 1,146,245,000 lekë, i barabartë me 1,146,245 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 1,352,212,000 lekë, i barabartë me 1,352,212 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e biznesit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Prodhim Mobilje" sh.a Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Milva Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES TIRANË

Nr 194 Prot
dt. 16/07/2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 10810/1 Prot. Tiranë, më 12.7.2019

## VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

**Nr. 55 Datë 12.7.19**

**PËR**

**ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "PRODHIM MOBILJE" SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 17781/3, datë 22.2.2019 "Për përgatitjen e dokumentacionit të zvogëlimit të kapitalit", me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë;

**VENDOSA:**

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 825,000 lekë, i barabartë me 825 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 1,351,387,000 lekë, i barabartë me 1,351,387 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Anila Denaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIRANË

# RAPORT

# PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT

# TE SHOQERISE "PRODHIM MOBILJE" SHA

# TIRANE

**Auditues Ligjor**

**Aida Maloku**

**Tirane, me 05.06.2019**

**RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR MBI NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "PRODHIM MOBILJE" TIRANE**

(Reference pasqyrat financiare 2018)

**Drejtuar: Ministrise se Financave dhe Ekonomise**

**Shoqerise: Prodhim Mobilje sha, Tirane**

Me cilesine e Audituesit Ligjor, sipas Shkreses Nr.17781/3, date 22.02.2019 te Ministrise se Financave dhe Ekonomise jam caktuar me Vendimin nr.10, date 22.02.2019 te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve -Per pergatitjen e raportit per zvogelimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise "Prodhim Mobilje" sha Tirane per: Vleren e objektit 25-27, sipas VKM-se Nr.346, date 24.04.2013 "Per kthim ne fond banesash te disa objekteve te ish Kombinatit te Tekstileve te Pambukta dhe objekteve te vjetra te ish-uzines Dinamo e Re Tirane".

Sipas VKM nr.346, date 24.04.2013 objektet e ish Kombinatit te Tekstileve te Pambukta dhe objektet e vjetra te ish-uzines Dinamo e Re do ti kalojne Entit te Banesave me qellim privatizimin ne favor te banoreve te pastrehe te cilet banojne ne keto objekte.

**Baza ligjore:**

- Ligji Nr. 7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 25/2018, date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare".
- Ligji Nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Auditues Ligjor dhe Kontabilistit te Miratuar" i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9723, date 05.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.

**Pergjegjesia e Drejtimit te shoqerise** "Prodhim Mobilje" sha, Tirane eshte: Pergatitja dhe paraqitja e drejte e deklarimeve financiare, juridike dhe informacioneve te tjera te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit te vleresimit te zvogelimit te kapitalit te shoqerise.

**Pergjegjesia jone** eshte te shprehim nje opinion mbi zvogelimin e kapitalit te shoqerise "Prodhim Mobilje" sha Tirane, per: Vleren e objektit 25-27 me siperfaqe 700 $m^2$, sipas VKM-se Nr.346, date 24.04.2013 "Per kthim ne fond banesash te disa objekteve te ish Kombinatit te Tekstileve te Pambukta dhe objekteve te vjetra te ish-uzines Dinamo e Re Tirane".

Shoqeria "Prodhim Mobilje" sha Tirane eshte themeluar date 10.11.1998 si shoqeri anonime me kapital te regjistruar aktual 1.352.212.000 leke i cili eshte ndare ne 1.352.212 aksione me vlere nominale 1.000 leke /aksioni, teresisht e shlyer, me aksioner te vetem Ministrine e Financave dhe Ekononise. Aktiviteti i shoqerise eshte: "Prodhim Mobilje e orendi prej lende druri si: Pajisje zyrash, shkollash, dhoma gjumi, stazhonim, prodhime me porosi dhe material porosites" ne fakt shoqeria nuk e ushtron kete aktivitet por vetem jep me qera objektet qe ka ne administrim.

Raportin e vleresimit te zvogelimit te kapitalit e mbeshtesim ne pasqyrat financiate te vitit 2018, te cilat jane te audituara nga auditues ligjor.
Me poshte po sqarojme pozicionet e aktivit dhe te pasivit te pasqyrave financiare 2018:

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| Nr | | | A K T I V E T | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Aktivet Afatshkurtra** | | | | |
| | ► | **Aktivet monetare** | | **101,362** | **401,120** |
| | | 1 | Banka | **101,349** | **341,447** |
| | | 2 | Arka | **13** | **59,673** |
| | ► | **Investime** | | | |
| | ► | **Të drejta të arkëtueshme** | | **12,594,957** | **13,043,002** |
| | | 1 | *Nga aktiviteti i shfrytëzimit* | 4,198,265 | 4,209,122 |
| | | 2 | *Nga njësitë ekonomike brenda grupit* | | |
| | | 3 | *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | |
| | | 4 | *Të tjera* | 8,396,692 | 8,833,880 |
| | | 5 | *Kapital i nënshkruar i papaguar* | | |
| | ► | **Inventarët** | | **8,589,655** | **8,618,238** |
| | | 1 | *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme* | 6,170 | 34,753 |
| | | 2 | *Inventar i imet* | | |
| | | 3 | *Produkte të gatshme* | 186,835 | 186,835 |
| | | 4 | *Mallra* | | |
| | | 5 | *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)* | | |
| | | 6 | *AAGJM të mbajtura për shitje* | 8,396,650 | 8,396,650 |
| | | 7 | *Parapagime për inventar* | | |
| | ► | **Shpenzime të shtyra** | | | |
| | ► | **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara** | | | |
| I | **TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA** | | | **21,285,974** | **22,062,360** |
| | **Aktivet Afatgjata** | | | **1,715,944,664** | **1,336,075,341** |
| | ► | **Aktive financiare** | | | |
| | ► | **Aktivet materiale** | | **1,715,944,664** | **1,336,075,341** |
| | | 1 | *Toka dhe ndertesat* | 1,715,700,248 | 1,335,595,926 |
| | | 2 | *Impiante dhe makineri* | 61,414 | 300,465 |
| | | 3 | *Të tjera Instalime dhe pajisje* | 183,002 | 178,950 |
| | | 4 | *Parapagime për aktive materiale dhe në proces* | | |
| | ► | **Ativet biologjike** | | | |
| | ► | **Aktive jo materiale:** | | **0** | **0** |
| | ► | **Aktive tatimore të shtyra** | | | |
| | ► | **Kapitali i nënshkruar i papaguar** | | | |
| II | **TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA** | | | **1,715,944,664** | **1,336,075,341** |
| | **A K T I V E T O T A L E** | | | **1,737,230,638** | **1,358,137,701** |
| | **Llogari jashte bilancit** | | | **5,189,633** | **5,189,633** |

| Nr | | | DETYRIMET DHE KAPITALI | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|---|---|
| | ► | | **Detyrime afatshkurtra:** | **46,365,761** | **34,616,479** |
| | | 1 | *Titujt e huamarrjes* | | |
| | | 2 | *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | |
| | | 3 | *Arkëtime në avancë për porosi* | 355,200 | 256,300 |
| | | 4 | *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | 5,324,153 | 220,500 |
| | | 5 | *Dëftesa të pagueshme* | | |
| | | 6 | *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore* | 11,368,333 | 7,661,144 |
| | | 7 | *Të pagueshme për detyrimet tatimore* | 2,219,946 | 2,320,767 |
| | | 8 | *Te tjera* | 27,098,129 | 24,157,768 |
| | ► | | **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | |
| | ► | | **Të ardhura të shtyra** | | |
| | ► | | **Provizione** | | |
| | | | **Totali i Detyrimeve afatshkurtera** | **46,365,761** | **34,616,479** |
| | ► | | **Detyrime afatgjata:** | **0** | **0** |
| | | 1 | *Titujt e huamarrjes* | | |
| | | 2 | *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | |
| | | 3 | *Arkëtimet në avancë për porosi* | | |
| | | 4 | *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | | |
| | | 5 | *Të tjera të pagueshme* | | |
| | ► | | **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | |
| | ► | | **Të ardhura të shtyra** | | |
| | ► | | **Provizione** | | |
| | ► | | **Detyrime tatimore të shtyra** | | |
| | | | **Totali i Detyrimeve afatgjata** | **0** | **0** |
| | | | **D E T Y R I M E T   T O T A L E** | **46,365,761** | **34,616,479** |
| | ► | | **Kapitali dhe Rezervat** | | |
| | ► | | **Kapitali i Nënshkruar** | **1,352,212,000** | **1,352,212,000** |
| | ► | | **Primi i lidhur me kapitalin** | | |
| | ► | | **Rezerva rivlerësimi** | **394,807,359** | |
| | ► | | **Rezerva të tjera** | **1,095,277** | **1,095,277** |
| | | 1 | *Rezerva ligjore* | | |
| | | 2 | *Rezerva statutore* | | |
| | | 3 | *Rezerva të tjera* | 1,095,277 | 1,095,277 |
| | ► | | **Fitimi i pashpërndarë** | -29,786,055 | -21,930,012 |
| | ► | | **Fitim / Humbja e Vitit** | -27,463,704 | -7,856,043 |
| | | | **Totali i Kapitalit** | **1,690,864,877** | **1,323,521,222** |
| | | | **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | **1,737,230,638** | **1,358,137,701** |
| | | | **Llogari jashte bilancit** | **5,189,633** | **5,189,633** |

Objekti 25-27 ne shkresen e Ministrise ne fakt eshte objekti 25-75 ne librat kontabel te shoqerise. Ai eshte nje objekt ndertimor ne formen e nje kapanoni me mure tulle, kolona beton armeje si skelet dhe soleta b/a si mbulese. Objekti eshte i zene me persona te trete. Ne kontabilitetin e shoqerise nuk eshte e perfshire toka mbi te cilin eshte ndertuar ky objekt, shoqeria nuk ka dokument hipotekor per te. Objekti 25-27 eshte rivleresuar nga eksperte te vleresimit te pasurive te pandundshme dhe ka keto te dhena:

- Vlere e mbetur para rivleresimit 825.588 leke.
- Vlera e rivleresuar 5.619.775 leke dhe,
- Diference rivleresimi ne shumen 4.794.187 leke.

Ndryshimi i kapitaleve te veta do te behet per vleren 825.588 leke.

Kapitali aksionar i regjistruar ne QKB para zvogelimit eshte 1.352.212.000 leke, i barabarte me 1.352.212 aksione me vlere nominale 1.000 leke/aksioni, me aksioner te vetem Ministrine e Financave dhe Ekonomise.

Kapitali aksionar i regjistruar do te zvogelohet per 825.000 leke duke zvogeluar rezervat e tjera per vleren 588 leke per efekt te rrumbullakimit te aksioneve, kapitali do te zvogelohet duke ruajtur te njejten vlere nominale per aksion.

Veprimet ne kontabilitetin e shoqerise jane:
1. Zvogelim i kapitalit te regjistruar te shoqerise ne shumen 825.000 leke.
2. Zvogelim te aam-ve ne shumen 5.619.775 leke.
3. Zvogelim te zerit Rezerva nga rivleresimi ne shumen 4.794.187 leke.
4. Zvogelim te rezervave te tjera ne shumen 588 leke.

Kapitali i regjistruar i shoqerise "Prodhim Mobilje" sha Tirane do te zvogelohet per 825.000 leke.

- **Kapitali i regjistruar para zvogelimit ne QKB eshte 1.352.212.000 leke i barabarte me 1.352.212 aksione me vlere nominale 1.000 leke/aksioni, i zoteruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.**
- **Kapitali i regjistruar do te zvogelohet per 825.000 leke e barabarte me 825 aksione me vlere nominale 1.000 leke/aksioni.**
- **Kapitali i regjistruar pas zvogelimit behet 1.351.387.000 leke (njemiliard e treqindepesedhjetenjemilion e treqindetetedhjeteshtatemije), i barabarte me 1.351.387 aksione me vlere nominale 1.000 leke/aksioni, te cilat i perkasin totalisht Ministrise se Financave dhe Ekonomise.**

Ky raport mbahet ne 3 (tre) kopje te njejta.

**Auditues Ligjor** **Tirane me 05.06.2019**

**Aida Maloku**

EKSPERT. KONTABEL I AUTORIZUAR AIDA. MALOKU.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
PRODHIM MOBILJE SH.A
TIRANË
*Adresa: Rruga e Kavajës, Ish-Kombinati i Drurit "MistoMame" E-mail: prodhim.mobilje@hotmail.com Tel.0682045455*

**Tiranë më 16 / 9 / 2020**

## MARRËVESHJE PËR BASHKIM ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE : ALBTURIST T.O. SHA, AEROPORTI "NËNË TEREZA" SHA, NPV SHA DURRËS, PRODHIM KABLLO SHKODËR, KRIPA SHA VLORË, ELBER SHPK ELBASAN, NGA PRODHIM MOBILJE SHA TIRANË

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", neni 216, dhe Vendimeve Nr 112-117, dt. 05/12/2019, të **Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë** në cilësinë e **Aksionarit të vetëm**, **Projekt/marrëveshjeve** të hartuara nga përfaqësuesit ligjor të shoqërive dhe publikuar në dt.15/07/2020 në QKB, hartohet **Marrëveshja për bashkim me përthithje** të shoqërive, ku shoqëria përthithëse është shoqëria **"Prodhim Mobilje" sh.a.** dhe shoqëritë e përthithura me të dhënat sipas tabelës më poshtë:

| Nr | Emërtimi shoqërisë | Statusi sipas Marreveshjes së bashkimit | NIPTI | Adresa | Përfaqësuesi Ligjor | Kapitali themeltar Lek |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Prodhim Mobilje Sha** | **Shoqëria Përthithese** | **J61827055V** | **Rr. e Kavajës Tiranë** | **Arban TARIFA** | **1,351,387,000** |
| 2 | Albturist T.O. Sha | Shoqëria Përthithur | K31623038D | Rr. Kavajës Tiranë | Pavlina Konini | 90,501,565 |
| 3 | Aeroporti Nënë Tereza Sha | Shoqëria Përthithur | J61820023S | Rr. e Durrësit Tiranë | Fatmir Cibaku | 2,769,890,000 |
| 4 | NPV Sha | Shoqëria Përthithur | K71309502E | Rr.A.Goga L.18 Durrës | Gëzim Çullaj | 73,893,000 |
| 5 | Prodhim Kabllo Sha | Shoqëria Përthithur | J66902025D | Z. Industriale Shkodër | Llazar Berati | 938,200,000 |
| 6 | ND/JA "KRIPA" Sha | Shoqëria Përthithur | J66703246N | L.Hajro Cakerri Vlorë | Besnik Demaj | 17,167,569,000 |
| 7 | ELBER Shpk | Shoqëria Përthithur | K13621201W | Lagja Dyli&Haxhire Myzyri,Ish NBSH Elbasan | Ledja Kollçinaku | 83,000,000 |
| | Kapitali themeltar pas bashkimit | | | | | **22,474,440,565** |

Administrator i shoqërisë përthithëse, **"Prodhim Mobilje" sh.a.,** sipas shkresës Nr.23206/1 date 17.12.2019 dhe Vendimit të **Asamblese së Përgjithëshme** të Aksionerit Nr.127/1 datë 17.12.2019 është Arban TARIFA, *identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. H40609105H e lëshuar ne datë 26.04.2018, i* cili do të qëndrojë në detyre nga data : 17/12/2019 Deri : 17/12/2022.

Për modalitetet e bashkimit të shoqërive u përpiluan raportet e përbashkët, të cilët u depozituan rregullisht bashkë me projekt marrëveshjet.

Për të kryer ketë mision dhe të gjitha modalitetet e bashkimit, sipas Vendimeve të Asamblesë së Përgjithëshme Nr.112-117, datë 05.12.2019, janë emëruar Ekspertët Kontabël e Regjistruar të cilët kanë hartuar (faza e parë e bashkimit) "Raportin e Bashkimit" i depozituar QKB dt 15/07/2020:

- **Aida MALOKU me NIPT K32612411T,** me Liçensë Nr. 55 datë 31.01.2000,

  Mobil: 0692063464 malokuaida@yahoo.com
- **Z.Lavdimir FUSHA me NIPT K92302060P** me Liçensë Nr. 97 datë 13.12.2000,

  Mobil: 0692067870 lavdimir.fusha@albanianaudit.com
- **Z.Neshat MAZE me NIPT K92302060P** , me Liçensë Nr. 148 datë 21.07.2005.

  Mobil: 067 20 79 155 ,E-mail lireng.auditing@gmail.com

Shoqëritë e përthithura **sipas tabelës më lart** do të kalojnë të gjitha pasuritë e tyre tek shoqëria **"Prodhim Mobilje" sh.a.**
***Shoqëria përthithëse do të gëzojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëritë e përthithura kishin në momentin e përthithjes,*** **përfshirë edhe ato tatimore sipas sistemit elektronik.**

Me bashkimin e shoqërive, shoqëria përthithëse është pronare 100% e shoqërive të përthithura. Si rrjedhim raporti i pjesëmarrjes në aksione në shoqërinë përthithëse pas bashkimit do të jete si në nivelet e mëposhteme, përkatësisht:

- ***Ministria Financës dhe Ekonomisë, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 100% të kapitalit themeltar të shoqerisë. Numri i total i kuotave 22,474,440.565, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) Lek.***

Me bashkimin e shoqërive, lind nevoja për ristrukturim e riorganizim të shoqërisë përthithëse, si pasojë e krijimit të një situate të re ekonomike-financiare. Punonjësit që mund të dalin të tepërt nga ristrukturimi organizativ i shoqërisë së re do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.
Organet e administrimit të shoqërisë përthithëse kanë po ato të drejta dhe detyrime që kanë gëzuar përpara bashkimit të shoqërive.

Shoqëria përthithëse **"Prodhim Mobilje" sh.a.** do të marrë në aktivin dhe pasivin e bilancit të saj, të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërive të përthithura sipas bilanceve të datës 31.12.2019 dhe të gjitha veprimet kontabël të kryera nga shoqëritë e përthithura gjatë vitit 2020 do të

regjistrohen në kontabilitetin e shoqërisë përthithëse, pra atë të shoqërisë **"Prodhim Mobilje" sh.a.**

Me miratimin e bashkimit me përthithje në QKB, palët duhet të kryejnë veprimet:

1.Dokumentacioni i zotëruar nga shoqëritë e përthithura deri në datën e miratimit të bashkimit nga QKB ti dorëzohet me Proces Verbal të rregullt shoqërisë përthithëse Prodhim Mobilje Sha Tiranë të cilat do të ruhen sipas afateve të përcaktuara ligjërisht.

2.Të dorëzohen tek shoqëria përthithëse Prodhim Mobilje Sha me Proces Verbal inventarët:
- Aktive Afatgjata Materiale
-Aktive Afatshkurtra Materiale
-Furnitorë
-Klientë
-Debitore / Kreditorë të tjerë

3.Të ndryshohet pronësia e mjeteve të transportit (në se ka) duke i kaluar te shoqëria përthithëse.

4.Të bëhet kalimi i llogarive bankare i shoqërive të përthithura tek shoqëria Prodhim Mobilje Sha.

5. Sipas sistemit elektronik tatimor Shoqëritë që përthithen rezultojnë me gjendje kreditore për TVSH dhe Tatim fitimi sipas tabelës më poshtë:

**Tabela e të drejtave dhe detyrimeve tatimore për shoqëritë që do të përthithen nga Prodhim Mobilje Sha**

| nr | Emertimi Shoqërisë | Kërkesa ndaj tatimeve sipas SE dt 14/09/2020 | | Detyrime ndaj tatime SE dt 14/09/2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | TVSH per tu kthyer (Lek) | Tat. Fitimi mbipaguar | TVSH për tu paguar (Lek) | Tat. Fitimi për tu paguar (Lek) |
| 1 | Albturist T.O. Sha | | | | |
| 2 | Aeroporti Nënë Tereza Sha | **233,146,187** | **36,891,782** | | |
| 3 | Prodhim Kabllo Sha | **450,629** | **1,558,133** | | |
| 4 | NPV Sha | | | | |
| 5 | ND/JA "KRIPA" Sha | | | **19,969,720** | **1,313,170** |
| 6 | ELBER Shpk | **14,873,097** | | | |
| | Shuma | | | | |

Palët të bëjnë rregullimet në **deklaratën tatimore në sistem** për periudhën kur ndodhi bashkimi me përthithje për gjendjen debitore - kreditore për TVSH dhe Tatim Fitimi.
Pala e përthithur duhet të sqarojë me shkrim arsyen dhe mënyrën e krijimit të kësaj gjendjeje deri në datën e përthithjes në shënimet e analizave të llogarive kontabël.

Së fundmi "Palët" bien dakort që të autorizojnë Z. Arban TARIFA, –Administrator i shoqërisë përthithëse - të kryejë aplikimin në QKB për dorëzimin e dokumentacionit përfundimtar të procedurës së bashkimit me përthithje për të gjitha shoqëritë.

**Përfaqësuesit Ligjor/Administrator**

**Për shoqëritë që përthithen**

Pavlina KONINI

Fatmir CIBAKU

Gëzim ÇULAJ

Llazar BERATI

Besnik DEMAJ

Ledja KOLLÇINAKU

**Për shoqërinë përthithëse**

Arban TARIFA